

RAPORTI HULUMTUES NDIKIMI I STEREOTIPEVE DHE DISTANCËS ETNIKE PËR SHFAQJEN E DISKRIMINIMIT, GJUHËS SË URREJTJES DHE KRIMIT NGA URREJTJA



RAPORTI HULUMTUES

NDIKIMI I STEREOTIPEVE DHE DISTANCËS ETNIKE PËR SHFAQJEN E DISKRIMINIMIT, GJUHËS SË URREJTJES DHE KRIMIT NGA URREJTJA

Publikimi:

Raporti Hulumtues – Ndikimi i stereotipeve dhe distancës etnike për shfaqjen e diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe krimit nga urrejtja

Redaktore:

d-r Zhaneta Poposka

Autorë:

d-r Strashko Stojanovski

d-r Zhaneta Poposka

Hulumtues kryesor:

d-r Strashko Stojanovski

Ekipi Hulumtues nga Universiteti “Goce Dellçev” – Shtip:

prof. d-r Strashko Stojanovski, Elena Trajkovska, Kire Ivanov, Nikolla Llazarevski, Aleksandar Simonov, Marina Karova, Antonio Stoillov dhe Andrej Mitevski

Ekipi Hulumtues nga Universiteti Shtetëror i Tetovës:

doc. d-r Agim Nuhiu, Elmira Amzi, Egzona Osmani, Meral Ameti, Gent Beqiri, Driton Islami dhe Aqif Beadini

Ekipi Hulumtues nga Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” – Shkup:

doc. d-r Llazar Jovevski, Ivona Petrushevska, Natalija Ilievska, Vllatko Tokarev, Vafire Muharemi, Stefani Nedellkova dhe Elena Kuzmanovska

Korrektura:

Elena Georgievska

CIP - Katalogizacija vo publikacija

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

316.647.82:343.63:]323.1(497.7)(047)

СТОЈАНОВСКИ, Страшко

Истражувачи извештај : влијанието на стереотипите и етничката дистанца за појава на дискриминација, говор на омраза и криминал од омраза / [автори Страшко Стојановски, Жанета Поповска]. - Скопје : ОБСЕ, 2016. - 65, 64 стр. : граф. прикази ; 21 см

Насл. стр. на припечатениот текст: Raporti hulumtues : ndikimi i stereotipeve dhe distancës etnike për shfaqjen e diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe krimit nga urrejtja / Strashko Stojanovski, Zhaneta Poposka. - Обата текста печатени во спротивни насоки. - Текст на мак. и алб. јазик. - Библиографија: стр. 65 ; 64. - Содржи и: Прилог = Shtojca

ISBN 978-608-4788-10-2

1. Поповска, Жанета [автор]. - I. Stojanovski, Strashko види

Стојановски, Страшко

а) Дискриминација - Говор на омраза - Етнички аспекти - Македонија - Извештаи

COBISS.MK-ID 102275594

Mbështetur nga:



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimin apo qëndrimin e Misionit të OSBE-së në Shkup. Misioni i përmbahet vendimit PC.DEC/81 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	4
HYRJE.....	5
TERMET DHE PËRKUFIZIMET E PËRDORURA	6
I. PËR EKZEMPLARIN HULUMTUES	7
1.1. Gjinia, mosha dhe zona e banimit.....	7
1.2. Përkatësia etnike dhe fetare	7
1.3. Arsimimi, statusi shoqëror dhe profesioni	8
II. GJETJET NGA HULUMTIMI I DISTANCËS ETNIKE	9
2.1. Njohja e gjuhës	9
2.2. Religjioziteti	9
2.3. Numri i anëtarëve në familje	11
2.4. Nevoja për mësuarjen e një gjuhe tjetër	11
2.5. Lloji i lagjes dhe bashkëveprimi etnik në kuadër të fqinjërisë	12
2.6. Përkatësia etnike, fetare dhe martesat ndëretnike.....	15
2.7. Ndikimi i stereotipeve mbi distancën etnike në nivelin kombëtar	16
2.8. Distanca etnike.....	19
2.9. Shkalla e lidhshmërisë me përkatësinë në grup – Shkalla e Likertit	24
III. GJETJET NGA HULUMTIMI I DISKRIMINIMIT, GJUHËS SË URREJTJES DHE KRIMIT NGA URREJTJA	29
3.1. Diskriminimi.....	29
3.1.1. Perceptimi për diskriminimin	29
3.1.2. Lufta kundër diskriminimit.....	34
3.2. Gjuha e urrejtjes.....	35
3.2.1 Perceptimi për gjuhën e urrejtjes	35
3.2.2. Përvojat me gjuhën e urrejtjes	40
3.3. Krimi nga urrejtja	41
3.3.1. Perceptimi për krimin nga urrejtja.....	41
3.3.2. Përvojat me krimin nga urrejtja	45
IV. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET	47
SHTOJCA 1 – Metodologjia.....	51
SHTOJCA 2 – Pyetësi anketues	52
SHTOJCA 3 – Ekzemplari.....	63
BIBLIOGRAFIA	64

PARATHËNIE

Numri i hulumtimeve të bashkëveprimit ndëretnik në vend na zbulon se interesi i publikut shkencor për këtë lloj të problematikës nuk përputhet me ndërlikueshmërinë e strukturës etnike në shoqëri, e as me problemet e përditshmërisë, të cilët kanë burimin e vet në strukturën e tillë dhe në mekanizmat e menaxhimit të saj politik. Mas-mediat pothuajse çdo ditë po shpallin informacione për të shprehur mosbesim, armiqësi, acarime, konflikte me parashenja etnike, por kjo nuk duket të jetë një sfidë për hulumtime gjithëpërfshirëse të fundamenteve të manifestimeve të tilla të rezistencës ose armiqësisë ndaj të tjetrit.

Megjithatë, do të kishim mund të përmendim disa hulumtime të dukurive etnike në vend, të realizuara nga psikologë dhe sociologë të Fakultetit të Filozofisë pranë Universitetit “Sh. Kirili dhe Metodi”. Njëri nga këto hulumtime¹ që ka filluar realizimin e vet që në vitin 1995, nga anëtarët e Institutit të Sociologjisë pranë Fakultetit të Filozofisë, kishte për qëllim ndërtimin e një kornize metodologjike për ndjekje të vazhdueshme të dukurive etnike në vend. Qëllimi i planifikuar ishte që hulumtimi sipas metodologjisë së zhvilluar, të përsëritej brenda një intervali kohor 5-vjeçar. Fatkeqësisht, anëtarët e Institutit devijuan nga ky qëllim, por prapëseprap, për metodologjinë e zhvilluar shfaqën interes studentë të tyre të diplomuar në studimet pasdiplomike dhe të doktoratës. Kështu, Frosina Tashevska Remenski, në vitin 2003 zbatoi një hulumtim të popullatës studentore, me tematikë për të cilën dukshëm flet vetë titulli i librit në të cilin janë prezantuar gjendjet e regjistruara – „Shqiptarët dhe Maqedonasit: bashkëveprimi etnik në vend, para dhe pas konfliktit të vitit 2001 (Shkup, 2005)“. Në vitin 2015, sipas një metodologjie të afërt, duke përfshirë popullatën e re (nga 16 – 24 vjeç), është zbatuar një hulumtim nga ekipi hulumtues i fakulteteve juridikë të Universitetit “Goce Dellçev” në Shtip, të Universitetit Shtetëror të Tetovës dhe të Universitetit “Sh. Kirili dhe Metodi” në Shkup, i mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Shkup, rezultatet e të cilit janë prezantuar në këtë studim.

Afërsia e instrumentariumit metodologjik në të tre hulumtimet e përmendura, jep mundësinë e ndjekjes së gjendjeve në sferën e bashkëveprimit etnik në vend. Analiza krahasuese na zbulon se në periudhën gjatë njëzet viteve të fundit, gjërat në planin etnik kanë ndryshuar shumë pak. Megjithatë, mund të vërehen lëvizje të caktuara. Kështu: lidhur me çështjen pandërprerë të shqyrtuar të gjuhës, po vazhdon tradita e diglosisë (komuniteti shumicë në përqindjen më të madhe flet vetëm gjuhën e vet, kurse komunitetet tjera në përqindjen më të madhe flasin gjuhën e vet dhe gjuhën e shumicës) edhe përskaj të gjitha insistimeve për futjen në përdorim të dygjuhësisë (ose shumëgjuhësisë), por megjithatë tek popullata e re mund të konstatohet rritja e vetëdijes për nevojën nga mësuarja e gjuhëve të tjerëve; sa i përket religjiozitetit, më e lartë është lidhshmëria fetare e pjesëtarëve të komunitetit shqiptar (dhe në përgjithësi të komuniteteve muslimane), gjë kjo e cila mund (por jo domosdo) të referojë drejt një çiftimi midis fesë dhe etnisë, gjegjësisht, të mbijetesës së të ashtuquajturit “religjiozitet etnik”; traditat e vendosura familjare (numri i anëtarëve në familje) po vazhdojnë, por me tendencën e pakësimit të numrit të anëtarëve tek të gjitha komunitetet; bashkëveprimi ndëretnik mbetet të jetë i ulët, mes tjerash, edhe për shkak të segregimit tanimë të vendosur hapësinor, por përgjigjet e grumbulluara në kontekstin e hulumtimit nuk zbulojnë qëllime më të shprehura për segregimin e mëtejshëm me parashenjë etnike, etj.

Një lëvizje e dukshme mund të konstatohet në lidhje me paragjykimet. Në këtë studim janë prezantuar rezultatet nga tre hulumtimet e përmendura, nga të cilat mund të konstatohet mbijetesja e stereotipit negativ në mesin e pjesëtarëve të komunitetit maqedon dhe atë shqiptar, me theks në karakterin konkurrues të paragjykimeve, si dhe ndryshimet e njëkohëshme në autostereotipin, të cilat zbulojnë rritjen e vetëbesimit tek të dy komunitetet. Komuniteti turk është më i preferuari, të paktën sipas llojit të paragjykimeve në lidhje me të, përderisa veçoritë të cilat i mvishen komunitetit rom edhe më tej na zbulojnë mbijetesën e paragjykimeve të llojit paternalist.

Ndërkaq, si hulumtuesi kryesor i projektit të vitit 1995, po e theksoj shpresën time se ky hulumtim do të arrijë përsëritjen e tij pas pesë vitesh dhe me këtë do t’i përgjigjet nevojës për një karakter dinamik, ashtu siç është dhe bashkëveprimi etnik, që të hulumtohet në pajtim me natyrën e tij të ndryshueshme.

¹ Shihni: Tasheva, Marija (1997) „Aspekti sociologjik i bashkëjetesës etnike”. Shkup: Fakulteti i Filozofisë - Shkup.

HYRJE

Brenda këtij publikimi janë prezantuar rezultatet e hulumtimit të zbatuar në kuadër të Projektit “Ndikimi i stereotipeve dhe distancës etnike për shfaqjen e diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe krimin nga urrejtja”. Hulumtimi është realizuar si pjesë e aktiviteteve të përbashkëta të fakulteteve juridikë pranë universiteteve “Goce Dellçev” nga Shtipi, “Justiniani I” nga Shkupi, si dhe Fakulteti Juridik pranë Universitetit Shtetëror në Tetovë, dhe është mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Shkup. Hulumtimi anketues u zbatua gjatë vitit 2015, duke u bazuar mbi një kornizë metodologjike të hartuar paraprakisht, në të cilin marrin pjesë një pjesë e studentëve dhe stafit akademik pranë Qendrës për Hulumtime Juridiko-Politike në kuadër të Fakultetit Juridik të Universitetit “Goce Dellçev” në Shtip. Hulumtimin e zbatuan ekipe të profesorëve dhe studentëve nga tre fakultetet juridikë të përmendur më lartë. Procesimi i të dhënave dhe i analizës gjatë viteve 2015 dhe 2016 u zbatua në hapësirat e Fakultetit Juridik pranë Universitetit “Goce Dellçev” në Shtip. Gjatë hulumtimit të zbatuar janë përfshirë disa tërësi që kanë të bëjnë me faktorë të ndryshëm shoqërorë (gjinia, moshë, përkatësia etnike dhe fetare, statusi shoqëror, arsimimi, e ngjashëm) sipas perceptimeve të të anketuarve, si dhe me ndërtimin e bashkëveprimit etnik, bashkëjetesës, apo e kundërta e këtyre, distanca etnike. Ndërkaq, janë përfshirë aspekte të ndryshme të analizës së stereotipeve ekzistues dhe të ndikimit të tyre për vendosjen e distancës etnike, kurse në këtë segment janë përdorur dhe Shkalla e Bogardusit dhe Shkalla e Likertit. Në pjesën e fundit janë prezantuar rezultatet lidhur me diskriminimin, gjuhën e urrejtjes dhe krimin nga urrejtja, të cilat bazoheshin mbi Metodologjinë e Hartimit të Barometrit të Mundësive të Barabarta, të përshtatur në përputhje me nevojat e grupit qëllimor të të anketuarve.

Veç rezultateve të prezantuara të këtij hulumtimi, në kuadër të këtij publikimi - në pjesën e parë të tij, me ndihmën e krahasimit me rezultatet e dy hulumtimeve në të cilat përdoret korniza e njëjtë ose e ngjashme metodologjike, do të bëhen përpjekje për të prodhuar projekte të gjeneruara nga dimensionin i gjatësisë së qasjes metodologjike. Gjegjësisht, bëhet fjalë për një krahasim me rezultatet e hulumtimit lartë përmendur, i zbatuar nga prof. d-r Marija Tasheva nga Instituti i Sociologjisë pranë Fakultetit të Filozofisë në Shkup, i cili është zbatuar në vitin 1995, ndërsa është publikuar me punimin e prof. d-r Marija Tasheva² në lidhje me grupet etnike në vend.³ Hulumtimi i dytë empirik që ka të bëjë me fuqizimin i komunikimit ndëretnik dhe integritit në vend në periudhën pas konfliktit është zbatuar nga Frosina Tashevska në vitin 2003, si pjesë e një hulumtimi më të gjerë, i cili është zbatuar për punimin master “Shqiptarët dhe Maqedonasit: Bashkëveprimi etnik në vend para dhe pas konfliktit të vitit 2001”, i cili është mbrojtur në vitin 2004 përpara Institutit të Sociologjisë pranë Fakultetit të Filozofisë në Shkup, nën mentorimin e prof. d-r Marija Tasheva.⁴

Veç kësaj, në pjesën e dytë, rezultatet e hulumtimit krahasohen me dy raporte hulumtuese, që bazohen në metodologjinë Eurostat. Ndërkaq, bëhet fjalë për krahasimin me rezultatet e “Barometrit të Mundësive të Barabarta”⁵, të zbatuar në vitin 2009 nga prof. d-r Violeta Petroska Beshka dhe prof. d-r Mirjana Najçevska, nga Qendra e të Drejtave të Njeriut dhe Zgjidhjes së Konfliktëve nga Shkupi, të publikuar nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN). Hulumtimi i dytë me titullin identik “Barometri i Mundësive të Barabarta”⁶, i zbatuar në vitin 2013 nga Misha Popoviç dhe Jasmina Mihaillovska, është publikuar nga QMBN në vitin 2013 në Shkup.

Lëndë e hulumtimit janë gjashtë bazat e njëjta të diskriminimit, të cilat janë hulumtuar edhe në kontekstin evropian, dhe të cilat janë definuar me direktivat kundër-diskriminuese dhe direktivat e gjinisë të Bashkimit Evropian (Direktiva 2000/78/EC, Direktiva 2000/43/EC, Direktiva 2004/113/EC dhe Direktiva 2006/54/EC), gjegjësisht diskriminimi në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike, fesë ose bindjes, moshës, hendikepit dhe orientimit seksual. Për arsye të kontekstit aktual, në tre hulumtimet kombëtare është shtuar dhe diskriminimi në bazë të përkatësisë politike, me qëllim analizimi i perceptimit të prezencës së saj në kontekstin kombëtar. Gjatë analizimit të gjetjeve, shpesh bëhet krahasimi midis nëngrupeve të ndryshme të të anketuarve, të përcaktuar sipas veçorive socio-demografike në vijim: gjinia; moshë; zona e banimit – zona urbane dhe rurale; përkatësia etnike – veçmas, nëse janë maqedonas apo shqiptarë (si grupet e vetme etnike të përfaqësuara në ekzemplarin në numër të mjaftueshëm, i cili mundëson krahasime të arsyeshme); dhe përkatësia fetare – krishterë – ortodoks dhe muslimanë (si grupet e vetme fetare të përfaqësuara në ekzemplarin në numër të mjaftueshëm i cili mundëson krahasime të arsyeshme).

2 Shihni: Tasheva, Marija (1997) „Aspekti sociologjik i bashkëjetesës etnike”. Shkup: Fakulteti i Filozofisë - Shkup.

3 Shihni: Tasheva, Marija (1997) „Grupet etnike në vend”. Shkup: Fakulteti i Filozofisë - Shkup.

4 Shihni: Remenski, Frosina (2004) "Shqiptarët dhe Maqedonasit: Bashkëveprimi etnik në Republikën e Maqedonisë, para dhe pas konfliktit të vitit 2001". Shkup: Instituti i Sociologjisë, Fakulteti i Filozofisë – Shkup, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” - Shkup.

5 Shihni: Petrovska Beshka, Violeta dhe Najçevska, Mirjana (2009) Raport hulumtimi: Matësi për mundësi të barabarta. Shkup: Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar.

6 Shihni: Popoviç, Misha dhe Mihajlovska, Jasmina (2013) Matësi për mundësi të barabarta. Shkup: Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar

TERMET DHE PËRKUFIZIMET E PËRDORURA

Në Raport janë përdorur termet dhe përkufizimet në vijim:

NACIONALIZMI, si nocion ka një domethënie tepër të ndërlikuar dhe të gjerë. Me këtë nocion, ai mund të nënkuptohet si shprehje e karakterit kombëtar, pastaj mund të kuptohet si një idiomë me të cilën vjen në shprehje kombi, theksimi i aspiratave për bashkim të kombit si doktrinë e përzgjedhjes hyjnore të kombit, ose si tërë procesi i formimit të kombit. Në ditët tona, nacionalizmi po merr një konotacion negativ, duke identifikuar atë me shovinizmin.

PAKICA është një grup njerëzish i cili është më i vogël në numër, krahasuar me popullatën tjetër të shtetit, që është në një pozitë jodominuese, dhe anëtarët e të cilit kanë veçori etnike, gjuhësore ose fetare të ndryshme nga ato të popullatës tjetër dhe shprehin, të paktën në nënkuptim, ndjenjën e solidaritetit orientuar drejt ruajtjes së kulturës, traditës, fesë ose gjuhës së vet.

GRUPI ETNIK është një grup personash që ndajnë një kulturë të përbashkët të dallueshme; si një grup shoqëror, ai ndanë ideologji, institucione dhe zakone të përbashkëta, si dhe ndjenjën e njëtrajtshmërisë. Në kuadër të grupeve etnike ekziston një traditë e përbashkët kulturore dhe një ndjenjë e identitetit, dhe ajo ekziston si një nëngrup në kuadër të një shoqërie më të gjerë. Identiteti etnik, apo etnia është instanca e parë e identifikimit kolektiv, e cila bazohet mbi dallimet e perceptuara kulturore. Etnia është në mënyrë të pashmangshme e lidhur me kulturën dhe paraqet produktin e bashkëveprimit social, meqë është një produkt edhe kolektiv edhe individual në bashkëveprimin social dhe në vetë-identifikimin.

BASHKËVEPRIMI ETNIK si nocion përcakton ndikimin reciprok midis individëve, pjesëtarë të komuniteteve etnike, ose të komuniteteve etnike në përgjithësi; apo, është sinonimi i marrëdhënies shoqërore, i kuptuar si ndërveprim mes individëve, të cilët me vetëdije ose në mënyrë të menjëhershme ndikojnë njëri tjetrin. Në procesin e bashkëveprimit dallojmë disa lloje të marrëdhënieve: bashkëpunimin, konfliktin, konkurrencën, përshtatjen, akulturimin, asimilimin, marginalizimin, represionin, e ngjashëm.

Distanca etnike është ndjenja kolektive e afërsisë, respektivisht, distancimi në raport me grupet tjera, dhe e bazuar në kriteret e caktuara objektive, të cilat në këtë rast dalin nga ndjenja e përkatësisë një komuniteti të caktuar etnik. Distanca etnike është produkt i stereotipeve dhe perceptimeve të cilat subjektivizohen dhe si rrjedhojë, shumë shpesh ofrojnë një pasqyrë të shtrembëruar për Tjetërsinë.

KONFLIKTET ETNIKE paraqesin përplasje midis dy ose më tepër grupeve të ndryshme etnike, ku brenda përplasjes vijnë në shprehje pikërisht dallimet etnike dhe kulturore. Pothuajse çdoherë në konfliktet etnike marrin pjesë grupe të pakicave të cilat popullojnë një territor të caktuar ku përbëjnë shumicën dhe e ndiejnë atë tradicionalisht apo historikisht të veten.

STEREOTIPET OSE PARAGJYKIMET formohen në mënyrë që njerëzve u përshkruhen tipare dalluese dhe karakteristika të caktuara vetëm e vetëm në bazë të përkatësisë së tyre ndonjë grupi të caktuar. Në fakt, stereotipet formohen në bazë të gjinisë, moshës, dallimeve etnike, racës, e ngjashëm. Ndërkaq, për stereotipet thuhet se janë qëndrime shumë të fuqishme, më së shpeshi të vendosura pa një bazë reale. Stereotipet dhe paragjykimet në masë të madhe vështirësojnë komunikimin midis njerëzve, për shkak të së cilës nevojitet tejkalimi i tyre. Stereotipet mund të ndërtohen në lidhje me grupin vetjak – si autostereotipe, si dhe në lidhje me grupet tjera, si heterostereotipe.

DISKRIMINIMI nënkupton çdo bërje të dallimit, çdo përjashtim, kufizim ose trajtim jo të barabartë ose mostrajtim, të motivuar nga baza të së kaluarës, baza aktuale ose të ardhshme, dhe ka për qëllim ose rezulton me pamundësimin ose vështirësimin e pranimit, ushtrimit apo praktikimit të të gjitha të drejtave dhe lirive nga gjithë personat me bazë të barabartë, respektivisht, vënien në trajtim më pak të favorshëm të një personi në krahasim me një person tjetër në situatë të ngjashme.

TOLERANCA paraqet aftësi për t'i pranuar dhe respektuar bindjet dhe vlerat shoqërore të personave tjerë dhe të grupeve tjera të njerëzve.

GJUHA E URREJTJES përfshin të gjitha format e shprehjes me të cilat përhapet, nxitet, promovohet ose arsyetohet urrejtja racore, ksenofobia, antisemitizmi ose format tjera të urrejtjes së bazuar mbi jotolerancën, duke përfshirë këtu dhe: jotolerancën e shprehur në formë të nacionalizmit agresiv dhe etnocentrizmit, diskriminimit dhe armiqësisë ndaj pakicave, migrantëve dhe personave me origjinë imigrante.

KRIMI NGA URREJTJA nënkupton krimin e motivuar nga jotoleranca e shfaqur ndaj grupeve të caktuara në shoqëri dhe përbëhet nga dy elemente: i pari, vepra patjetër duhet të jetë e kualifikuar si vepër penale në Kodin Penal dhe e dyta, motivi i kryerjes së veprës penale patjetër duhet të bazohet mbi një paragjykim të caktuar, apo kryerësi të zgjedh objektivin e veprës ndëshkuese në bazë të veçorive të mbrojtura.

I. PËR EKZEMPLARIN HULUMTUES

1.1. Gjinia, mosha dhe zona e banimit


Në kuadër të hulumtimit “Ndikimi i stereotipeve dhe distancës etnike për shfaqjen e diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe krimin nga urrejtja”, janë përfshirë 519 të anketuar. 41% të të anketuarve janë nga gjinia mashkullore, përderisa 59% janë nga gjinia femërore. Sipas përfaqësimit të kategorive të grupmoshave, 243 të anketuar, apo 46,8% janë në moshë nga 16 deri 18 vjeç, 255 të anketuar apo 49,1% janë në moshë nga 19 deri 21 vjeç, përderisa 17 të anketuar apo 3,3% janë në moshë nga 22 deri 24 vjeç. 38,7% të të anketuarve banojnë në fshat, përderisa 59% banojnë në qytet.

1.2. Përkatësia etnike dhe fetare


Sipas përkatësisë etnike, pjesa më e madhe e të anketuarve janë nga komuniteti etnik maqedonas dhe shqiptar. Ndërkaq, 342 të anketuar apo 65,9% janë maqedonas, dhe 156 të anketuar apo 30,1% janë shqiptarë. Komunitetet tjera etnike janë përfshirë në përqindje më të ulët, apo gjithsej përbëjnë rreth 4% të numrit të përgjithshëm të të anketuarve (Grafiku 1).

Sipas përkatësisë fetare të të anketuarve, 323 të anketuar apo 62,2% janë deklaruar se janë të konfesionit fetar krishter-ortodoks, 172 të të anketuarve apo 33,1% janë të konfesionit fetar islam, përderisa gjithsej rreth 4% të të anketuarve janë deklaruar të jenë nga konfisioni fetar katolik ose protestant, ateistë ose janë përcaktuar për alternativën “Tjetër” (Grafiku 2).

Grafiku 1



Grafiku 2




1.3.Arsimimi, statusi shoqëror dhe profesioni


209 të anketuar apo 40,3% janë nxënës të shkollave të mesme, nga të cilët 83 vizitojnë shkolla të mesme në Shkup, 56 të anketuar janë nga shkollat e mesme në Tetovë dhe Gostivar, kurse 71 të anketuar janë nga shkollat e mesme në Strumicë, Shtip dhe Vinicë. 307 të anketuar ose 59,2% janë studentë, nga të cilët 117 janë studentë pranë Universitetit “Goce Dellçev” në Shtip, 64 të anketuar janë studentë pranë Universitetit “Kirili dhe Metodi” në Shkup, dhe 125 të anketuar janë studentë pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës.

Statusi shoqëror i të anketuarve është përcaktuar në bazë të të ardhurave mujore në kuadër të familjes. Kështu, 7,3% të të anketuarve janë deklaruar se të ardhurat mujore në familjen e tyre është nën 8.000 denarë, që është ekuivalenti i statusit të ulët shoqëror, 17,3% të të anketuarve janë me të ardhura mujore në kuadër të familjes nga 8.000 deri 15.000 denarë, që i përgjigjet statusit të mesëm–të ulët shoqëror, 33,7% të të anketuarve janë me të ardhura mujore në kuadër të familjes midis 15.000 dhe 30.000 denarë, që është ekuivalenti i statusit të mesëm shoqëror, 22,2% janë me të ardhura mujore në familje nga 30.000 deri 60.000 denarë, që paraqet statusin e mesëm–të lartë shoqëror dhe në fund, 9,6% të të anketuarve janë me status të lartë shoqëror, apo kanë të ardhura mujore mbi 60.000 denarë (Grafiku 3). Gjithashtu, mund të vërehet dhe diversiteti në përgjigjet kur bëhet fjalë për profesionin e njërit nga prindërve (Grafiku 4). Ndërkaq, sipas profesionit dhe orientimit profesional të prindërve, më të përfaqësuara janë profesionet: punonjës në sektorin privat dhe atë bujqësor, punonjës në sektorin shoqëror dhe SH.A., zejtarë privatë dhe tregtarë, nëpunës, privatistë (pronarë të ndërmarrjeve më të mëdha), etj.

Grafiku 3



Grafiku 4



II. GJETJET NGA HULUMTIMI I DISTANCËS ETNIKE


2.1. Njohja e gjuhës

Në pyetjen që ka të bëjë me njohjen e gjuhëve që fliten në vend, dhe kjo nuk i përket gjuhës amë, të anketuarit shqiptarë në një përqindje të madhe njohin gjuhën maqedone, apo 84% dijnë të lexojnë dhe të shkruajnë në gjuhën maqedone, 2,6%, respektivisht 5,8% janë përcaktuar për alternativën se dijnë të lexojnë ose mund të përdorin gjuhën sa për komunikim, përderisa vetëm 1,3% nga të anketuarit shqiptarë pretendojnë se aspak nuk njohin gjuhën maqedone. Sa i përket të anketuarve maqedonas, 4,7% pretendojnë se dijnë të lexojnë dhe të shkruajnë në gjuhën shqipe, 1,5% pretendojnë se mund të përdorin gjuhën shqipe sa për komunikim, përderisa 93,8% pretendojnë se aspak nuk e njohin gjuhën shqipe. Sa i përket gjuhës turke, 35,8% nga të anketuarit shqiptarë, plotësisht ose pjesërisht njohin këtë gjuhë, kurse tek të anketuarit maqedonas, përqindja e atyre që pretendojnë se e njohin këtë gjuhë është e papërfillshme. As maqedonasit e as shqiptarët nuk njohin gjuhën rome, ose janë 5,6% të maqedonasve që pjesërisht njohin, ose mund të përdorin gjuhën rome sa për komunikim, si dhe janë 5,9% të të anketuarve shqiptarë që janë përgjigjur duke pohuar se pjesërisht ose në se mund të përdorin këtë gjuhë sa për komunikim. Të tjerët janë përgjigjur se nuk kanë njohuri. Lidhur me gjuhën serbe, niveli i njohjes së tij është më i lartë tek të anketuarit maqedonas, në raport me të anketuarit shqiptarë. Ose, vetëm 9,1% të maqedonasve pretendojnë se nuk njohin gjuhën serbe, kurse tek të anketuarit shqiptarë kjo përqindje arrin madje 43,6%.


2.2. Religjioziteti

Në pyetjen, **Si e përcaktoni religjiozitetin Tuaj?**, 6,4% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve pretendojnë se nuk janë aspak religjioz, 21,2% janë përcaktuar për alternativën “jam pak religjioz”, “të papërcaktuar fetarisht” janë vetëm 1,7%, kurse 56,5% të larta të numrit të përgjithshëm të të anketuarve janë përcaktuar si “religjioz”, kurse për alternativën “jam shumë religjioz” janë përcaktuar 9,2% nga të anketuarit (Grafiku 5). Sipas përkatësisë gjinore, gjinia femërore është më religjioze se ajo mashkullore. Ndërkaq, tek gjinia mashkullore, 51,4% janë “religjioz”, ndërsa 8% janë “shumë religjioz”; tek gjinia femërore, 60% janë përcaktuar për “religjioz”, kurse 10,2% për shumë religjioz”. Sipas moshës dhe kategorive të studentëve dhe nxënësve të shkollave të mesme, nuk ekziston një dallim i konsiderueshëm në perceptimin e tyre të religjiozitetit vetjak. Kur flasim për perceptimin e shkallës së religjiozitetit tek dy komunitetet më të mëdha etnike, nga përgjigjet mund të vërehet se të anketuarit me përkatësi etnike shqiptare janë më religjioz në krahasim me të anketuarit me përkatësi etnike maqedone. Kështu, tek të anketuarit maqedonas, 7,9% nga të anketuarit pretendojnë se “nuk janë religjioz”, 26% janë “më pak religjioz”, 54,7% janë “religjioz”, kurse vetëm 6,1% nga të anketuarit maqedonas pretendojnë se janë “shumë religjioz”. Aq më tepër se tek të anketuarit shqiptarë, vetëm 3,2% pretendojnë se “nuk janë religjioz”, 12,2% të ulëta pretendojnë se janë “pak religjioz”, 60,3% janë “religjioz”, kurse 14,1% të larta mbi mesataren, pretendojnë se janë “shumë religjioz” (Grafiku 6). Gjithashtu, mund të vërehet dhe një rritje minimale të religjiozitetit tek të anketuarit të fesë islame, në krahasim me ata që janë deklaruar si të krishter ortodoks. Në këtë mënyrë, tek të krishterët ortodoks, 26,9% janë “pak religjioz”, 57,9% janë “religjioz”, kurse vetëm 6,2% janë deklaruar si “shumë religjioz”. Domethënë, sipas përgjigjeve të të anketuarve të fesë islame, “pak religjioz” janë 11%; 60,5% janë deklaruar si “religjioz”, përderisa “shumë religjioz” janë 15,1% të të anketuarve të fesë islame (Grafiku 7).


Grafiku 5



Grafiku 6



Grafiku 7




2.3. Numri i anëtarëve në familje

10,4% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve jetojnë në familje tre-anëtarëshe, familja numëron 4 anëtarë tek 37% nga të anketuarit, 25,8% nga të anketuarit jetojnë në familje me 5 anëtarë, dhe në familje gjashtë-anëtarëshe jetojnë 12,9% nga të anketuarit, kurse 9% nga të anketuarit jetojnë në familje me dhe mbi 7 anëtarë. Përqindja më e lartë, respektivisht 48,3% nga personat e fesë ortodokse jetojnë në familje katër-anëtarëshe, ndërsa tek të anketuarit e fesë islame, përqindja është më e lartë dhe arrin 37,2% që jetojnë në familje pesë-anëtarëshe. E ngjashme është gjendja edhe kur bëhet fjalë për përkatësinë etnike e të anketuarve, ose 45,9% më të larta të maqedonasve jetojnë në familje katër-anëtarëshe, ndërsa 35,9% nga të anketuarit shqiptarë jetojnë në familje pesë-anëtarëshe. Lidhur me zonën e banimit, 41,3% nga të anketuarit që banojnë në fshat, jetojnë në familje pesë-anëtarëshe, kurse 46,7% nga të anketuarit që banojnë në qytet, jetojnë në familje katër-anëtarëshe. Të anketuarit më së shpeshti jetojnë në familje dy-brezëshe (prindër dhe fëmijë), 63% në familje tre-brezëshe (prindër, fëmijë dhe gjyshëri), respektivisht, 26,2%, ndërsa të tjerët jetojnë në familje me më shumë breze, ose së bashku me familjarët e ngushtë.


2.4. Nevoja për mësuarijen e një gjuhe tjetër

Në pyetjen **A duhet gjatë shkollimit të mësohet dhe një nga gjuhët të cilat fliten në vend?**, ekziston ndarja pothuajse e barabartë në përgjigje, gjegjësisht, 1/3 pretendojnë se nuk ekziston nevoja për mësuarijen e një gjuhe tjetër, 1/3 pretendojnë se detyrueshëm duhet të mësohet të paktën edhe një nga gjuhët që fliten në vend, kurse 1/3 e të anketuarve thonë se gjuha plotësuese duhet të mësohet në mënyrë fakultative (Grafiku 8). Për të anketuarit e komunitetit etnik shqiptar, shumë më e rëndësishme është mësuarija e edhe një gjuhe që flitet në vend, dhe kjo të mos jetë gjuha amë. Kështu, nëse tek maqedonasit 33,6% pretendojnë se nuk duhet mësuari një gjuhë tjetër, tek të anketuarit shqiptarë kjo përqindje arrin 13,5%. Ose, 57,1% nga të anketuarit shqiptarë konsiderojnë se mësuarija e një gjuhe tjetër duhet të jetë e detyrueshme, kurse për këtë alternativë janë përcaktuar vetëm 27,5% nga të anketuarit maqedonas. Megjithatë, më e lartë është përqindja tek të anketuarit maqedonas, të cilët konsiderojnë se gjuha e dytë, nga ato që janë përfaqësuar në vend, duhet të mësohet në mënyrë fakultative, apo më saktësisht 39,5%, ndërsa mësuarijen fakultative preferojnë 23,7% nga të anketuarit shqiptarë (Grafiku 9). Është interesant fakti se nuk ekziston dallimi tek qëndrimet lidhur me këtë pyetje në mesin e të anketuarve që jetojnë në zona etnike homogjene dhe heterogjene. Për të anketuarit maqedonas, nga gjuhët që përdoren në vend, më e preferuar, për 21,1%, është gjuha shqipe, 13,5% preferojnë gjuhën serbe, ndërsa për 13,2% është kjo gjuha turke. Për të anketuarit shqiptarë, gjuha e dytë më e preferuar, me 30,1% është gjuha maqedone, kurse 14,7% janë përcaktuar për gjuhën turke. Preferenca më e ulët edhe tek të anketuarit maqedonas me 1,5%, edhe tek të anketuarit shqiptarë me 0,6%, është gjuha rome.

Grafiku 8




Grafiku 9




2.5. Lloji i lagjes dhe bashkëveprimi etnik në kuadër të fqinjërisë

Pjesa më e madhe e të anketuarve banojnë në lagje homogjene etnike (Grafiku 10). Kështu, 62,9% nga të anketuarit maqedonas dhe 64,1% nga të anketuarit shqiptarë pretendojnë se banojnë në lagje homogjene etnike, ndërsa 36,5% nga të anketuarit maqedonas dhe 30,8% nga të anketuarit shqiptarë pretendojnë se banojnë në lagje homogjene etnike. Duhet shënuar se për diku dhjetë përqind më tepër të të anketuarve pretendojnë se banojnë në fqinjëri etnikisht homogjene, ose janë këto 72,5% nga të anketuarit maqedonas dhe 68,6% nga të anketuarit shqiptarë. Gjendja e këtillë reflektohet edhe në kuadër të bashkëveprimit shoqëror mes grupeve etnike. Kështu, në pyetjen **Cilës përkatësi etnike i takojnë fqinjët Tuaj me të cilët po shoqërizoheni?**, pjesa më e madhe thonë se fqinjët me të cilët shoqërizohen i takojnë grupit të tyre, dhe më pak grupit të tyre dhe një grupit tjetër (Grafiku 11). Bashkëveprimi i këtillë është më i lartë tek të anketuarit shqiptarë, përkundër të të anketuarve maqedonas. Kështu, 76,3% të larta nga të anketuarit maqedonas pretendojnë se fqinjët me të cilët shoqërizohen i takojnë vetëm grupit të tyre, kurse tek të anketuarit shqiptarë përqindja e këtillë është 56,4%, dhe me “grupit tim dhe grupit tjetër” janë përgjigjur 20,5% nga të anketuarit maqedonas dhe 34,6% nga të anketuarit shqiptarë. Kjo përmbledhje e pyetjeve tregon për një paralelizëm në kuadër të bashkëveprimit shoqëror, i cili lidhet me bashkëveprimit brenda grupit, me mundësi më të vogël për komunikim më intensiv jashtë etnive. Megjithatë, sipas perceptimeve, mund të vërehet dhe dëshira për bashkëveprim ndëretnik dhe kjo është më e madhe tek komuniteti etnik shqiptar, përkundër atij maqedonas.

Grafiku 10




Grafiku 11




Në pyetjen **A do të donit të shpërnguleshit nga lagjeja Juaj?**, pjesa më e madhe e të anketuarve janë përgjigjur negativisht. Me këtë, 44,3% të larta nga numri i përgjithshëm i të anketuarve janë përgjigjur me “Jo, sepse jam mësuar këtu”, kurse një numër më i ulët janë përgjigjur me “Jo, sepse lagjeja ka infrastrukturën e zhvilluar” (9,4%), dhe “Jo, sepse lagjeja është ekologjikisht e pastër” (8,9%). Nga ata të anketuar që janë përcaktuar se dëshirojnë të shpërngulen, 9,6% më të larta nga numri i përgjithshëm i të anketuarve pretendojnë se dëshirojnë të shpërngulen, meqë lagjeja nuk ka infrastrukturën e zhvilluar, 4,6% meqë lagjeja është e ndotur, dhe për 3,5% shpërngulja nevojitet pasi që lagjeja gjendet larg vendit të tyre të punës. Është interesante për ta shënuar se kur u bë kryqëzimi në bazë të përkatësisë etnike, pothuajse as nuk ekzistonte aspak dallimi midis grupeve etnike në vend lidhur me këtë pyetje, madje dhe ekziston në një preferencë të njësuar të përgjigjeve (Grafiku 12 dhe Grafiku 13). Gjithashtu, nuk ekzistojnë asçfarë dallimesh në qëndrimet rreth kësaj pyetjeje tek të anketuarit që banojnë në lagje etnike homogjene dhe në ato heterogjene.

Grafiku 12



Grafiku 13




Kur parashtrohet pyetja **Cilit komunitet etnik i takojnë tre nga miqtë Tuaj më të mirë?**, atëherë merret një përgjigje pothuajse e njësuar. Tek pjesëtarët e komunitetit etnik shqiptar, tre miqtë më të mirë janë shqiptarë, kurse tek ata të komunitetit etnik maqedonas, miqtë e tyre më të mirë në përqindje mbizotëruese, janë maqedonas.


E ngjashme është gjendja edhe kur bëhet fjalë për pyetjen **Cilës fe i takojnë tre miqtë Tuaj më të mirë?**, për të anketuarit e fesë krishtere ortodokse, miqtë janë nga komuniteti i tyre fetar, kurse tek të anketuarit e fesë islame, në përqindje mbizotëruese, tre miqtë më të mirë poashtu i takojnë grupit të tyre fetar.

31% të të anketuarve dëshirojnë të banojnë në një lagje ku banojnë vetëm pjesëtarë të grupit të tyre etnik, 12,9% janë përgjigjur se preferojnë të banojnë në lagje etnikisht të përzier, kurse 55,3% janë përgjigjur se nuk ka rëndësi se në çfarë lagje banojnë (Grafiku 14). Nuk ekziston dallimi tek grupet e ndryshme etnike në perceptimet lidhur me këtë pyetje dhe preferencat pothuajse po përputhen me qëndrimet e numrit të përgjithshëm të të anketuarve. Megjithatë, ekzistojnë dallime të konsiderueshme kur kombinohen pyetjet Në çfarë lagje po banoni dhe në çfarë lagje do të kishit dëshiruar të banonit. Është evidente se tek të anketuarit që tanimë banojnë në lagje etnike homogjene, mbizotëron dëshira që edhe më tej të vazhdojnë të banojnë në lagje të këtilla. Kështu, për ata që banojnë në një lagje etnikisht homogjene, 38,2% dëshirojnë të banojnë vetëm në lagje ku banojnë pjesëtarë të grupit të tyre etnik, 8,7% preferojnë të banojnë në lagje etnikisht të përziera, dhe për 52,2% nuk ka rëndësi. Tek të anketuarit që tanimë banojnë në një lagje etnikisht të përzier, 17,7% dëshirojnë të banojnë vetëm në lagje ku banojnë pjesëtarë të grupit të tyre etnik, 20,4% preferojnë të banojnë në lagje etnikisht të përzier, kurse 61,8% kanë deklaruar se nuk ka rëndësi se në çfarë lagje banojnë (Grafiku 15).

Grafiku 14




Grafiku 15




2.6. Përkatësia etnike, fetare dhe martesat ndëretnike

Pjesa më e madhe e të anketuarve, apo 66,5% të larta (59,8% nga të anketuarit janë të fesë ortodokse dhe 86,6% nga të anketuarit janë të fesë islame), konsiderojnë se është më mirë të lidhet martesë me një burrë/grua të fesë së njëjtë (Grafiku 16). Sa më i ulët është religjioziteti i të anketuarve, aq më e lartë është përqindja e atyre që janë të papërcaktuar ose preferojnë martesë me një burrë/grua që nuk janë fetarë. Megjithatë, edhe tek ata më pak religjioz nuk është e preferuar përkatësia tjetër fetare. Ashtu siç po rritet religjioziteti, ashtu po rritet dhe konservatizmi në qëndrimet lidhur me lidhjen e martesës me pjesëtarë të një feje tjetër. Tek të anketuarit që nuk janë religjioz, 36,4% preferojnë martesë me një burrë/grua të fesë së njëjtë, tek të anketuarit që janë pak religjioz, martesë e këtillë është preferuar për 59,1%, të anketuarit religjioz preferojnë martesë me një burrë/grua të fesë së njëjtë me 70,6%, kurse 77,1% nga të anketuarit shumë religjioz preferojnë martesë me një burrë/grua të fesë së njëjtë (Grafiku 16). Të ngjashëm janë qëndrimet e të anketuarve kur bëhet fjalë për lidhje të martesës me një burrë/grua të kombësisë së njëjtë, respektivisht, madje 61,1% (Grafiku 17). Nëse tek të anketuarit maqedonas, 53,5% konsiderojnë se është më mirë të lidhet martesë me një burrë/grua të përkatësisë së njëjtë etnike, tek të anketuarit shqiptarë në lidhje me të njëjtin qëndrim, përqindja është konsiderueshëm më e lartë dhe arrin 82,1% nga të anketuarit shqiptarë (Grafiku 18). Kjo tregon se distanca etnike është më e lartë tek të anketuarit shqiptarë, kur bëhet fjalë për mundësinë e lidhjes së martesës me grupe etnike jo të njëjlojshme.


Grafiku 16



Grafiku 17



Grafiku 18



2.7. Ndikimi i stereotipeve mbi distancën etnike në nivelin kombëtar

Hulumtimi ka të bëjë me ekzaminimin e veçorive dalluese të komuniteteve etnike individuale. Për çdo komunitet etnik u ofruan veçori të ndryshme pa ndonjë renditje të posaçme. Detyra e të anketuarve përbëhej nga këto në vijim: t'i lexonjin gjithë veçoritë e numëruara (atributet), dhe pastaj ta shënonjin numrin përpara pesë deri dhjetë veçorive për të cilat mendojnë se janë tipike ose karakteristike për komunitetin etnik në fjalë. Veçoritë tipike për një komunitet etnik janë ato veçori të cilat i posedojnë shumica e njerëzve (pjesëtarë) të atij komuniteti. Me këtë, u ofruan stereotipet, apo veçoritë në vijim: të guximshëm, krenarë, tinzakë, punëtorë, të vonuar, zemerbardhë, të pakulturar në sjellje, të vrazhdë, mikpritës, frigacakë, të qetë (të tërhequr), të harmonishëm, grindavecë, gazmorë, egoistë, përparimtarë, të zëshëm (të zhurmshëm), të prapambetur, të sjellshëm, përtacë, me besim në vete, të shoqërueshëm, të trashë (jointeligjentë), të papastër, luftarak, nuk duan kombet tjerë, bujarë, agresiv, të arsyeshëm, tepër të ndjeshëm, liridashës, jomikpritës, të ngutshëm (të vrullshëm), inteligjentë, dëshirojnë të sundojnë, të butë, paqedashës, të mbyllur, të pastër, arrogantë, të sinqertë, pijanecë, të gjindshëm, mendjemëdhenj, temperamentë, të kulturuar, praktikë, interesxhinj, mburravecë, ziliqarë, mitmarrës, kontrabandistë. Gjithashtu, të anketuarve u është lejuar mundësia për të shtuar ndonjë veçori, nëse ajo nuk gjendet në listën e ofruar.

Për shkak të numrit më të ulët të të anketuarve të përfshirë tek grupet më të vogla etnike, në kuadër të rezultateve do të prezantohen vetëm stereotipet të cilët të anketuarit nga grupi etnik maqedonas dhe nga ai shqiptar ndërtojnë ndaj të tjerëve. Nga hulumtimi mund të vërejmë se të anketuarit maqedonas pas vete

kanë stereotipe pozitive, si të guximshëm, krenarë, punëtorë, mikpritës dhe gazmorë. Në të njëjtën kohë, ky grup formon stereotipe ose veçori të supozuara ndaj të tjerëve. Kështu, në pesë stereotipet më të larta që ata kanë ndaj komunitetit shqiptar, ekzistojnë edhe veçori pozitive, si të guximshëm dhe të harmonishëm, por megjithatë mbizotërojnë veçoritë negative, siç janë të pakulturuar në sjellje, të vrazhdë dhe dëshirojnë të sundojnë. Të anketuarit shqiptarë për vete ndërtojnëtribute pozitive, si të guximshëm, krenarë, zemërbardhë, mikritës dhe luftarakë, kurse ndaj komunitetit maqedonas ndërtojnë stereotipe negative, si të vrazhdë, nuk duan kombe tjera, egoistë, dëshirojnë të sundojnë dhe ziliqarë. Që të dy grupet e të anketuarve, maqedonasit dhe shqiptarët, kanë stereotipe pozitive ndaj grupit etnik turk, dhe negative ndaj atij rom. Gjithashtu, maqedonasit kanë stereotipe pozitive për grupin etnik serb, kurse të anketuarit shqiptarë ndërtojnë stereotipe negative ndaj këtij grupi.

Ajo që mund ta vërejmë nga Tabela është se përqindja e preferencës së ndonjë veçorie të caktuar të cilën grupet ndërtojnë për veten është konsiderueshëm më e lartë në krahasim me atë kur e njëjta projektohet ndaj një grupi tjetër. Kështu për shembull, nëse 36,4% nga të anketuarit maqedonas për vete konsiderojnë se janë të guximshëm, si preferenca e parë, edhe pse e njëjta veçori në vend të parë u përshkruhet edhe tre grupeve tjera, përqindja e preferencës për serbët është 16,7%, për shqiptarët 12%, për turqët 10,2%. E ngjashme është gjendja edhe tek të anketuarit shqiptarë, ku qartë mund të vërehet se përqindja e preferencës së veçorive për grupin e vet është shumë më e lartë, në krahasim me veçoritë që u përshkruhen grupeve tjera. Për shembull, për veçorinë të “guximshëm” janë përcaktuar madje 59,6% nga të anketuarit shqiptarë. Kjo tregon për unifikimin e fuqishëm të qëndrimeve ndaj grupeve vetjake, përderisa për grupet tjera ekziston një dispersion i fuqishëm gjatë përzgjedhjes së veçorive të tyre (Tabela 1 dhe Tabela 2).

Tabela 1

MAQEDONASIT					
	STEREOTIPI 1	STEREOTIPI 2	STEREOTIPI 3	STEREOTIPI 4	STEREOTIPI 5
MAQEDONASIT	Të guximshëm (36,4%)	Krenarë (22,8%)	Punëtorë (14,9%)	Mikpritës (10,5%)	Gazmorë (9,1%)
SHQIPTARËT	Të guximshëm (12%)	Të pakulturuar në sjellje (9,9%)	Të harmonishëm (7%)	Të vrazhdë (5,3%)	Dëshirojnë të sundojnë (5,3%)
TURQËT	Të guximshëm (10,2%)	Mikpritës (7,6%)	Të harmonishëm (4,4%)	Përparimtarë (3,5%)	Punëtorë (4,4%)
ROMËT	Tinzakë / të pakulturuar në sjellje (7%)	Të vonuar (7,3%)	Të papastër (5,6%)	Të zhurmshëm (5,3%)	Të trashë (jointeligjentë) (5,3%)
SERBËT	Të guximshëm (16,7%)	Krenarë (10,5%)	Punëtorë (7%)	Gazmorë (6,1%)	Të sjellshëm / Të çiltër (4,1%)

Tabela 2

SHQIPTARËT					
	STEREOTIPI 1	STEREOTIPI 2	STEREOTIPI 3	STEREOTIPI 4	STEREOTIPI 5
MAQEDONASIT	Të vrazhdë (8,3%)	Nuk duan kombe tjera (5,1%)	Egoistë (5,8%)	Dëshirojnë të sundojnë (4,5%)	Ziliqarë (3,8%)
SHQIPTARËT	Të guximshëm (59,6%)	Krenarë (42,3%)	Zembardhë (19,2%)	Mikpritës (17,9%)	Luftarakë (9%)
TURQËT	Zembardhë (7,1%)	Krenarë (5,8%)	Të shoqërueshëm (4,5%)	Luftarakë / Të pastër (3,8%)	Të arsyeshëm (7,1%)
ROMËT	Të vonuar (9,6%)	Të pakulturuar në sjellje (4,5%)	Grindavecë (4,5%)	Të papastër (3,8%)	Të prapambetur (3,8%)
SERBËT	Agresivë (7,7%)	Të pakulturuar në sjellje (5,8%)	Grindavecë (5,1%)	Të prapambetur / Interesxhinj (3,2%)	Dëshirojnë të sundojnë (4,5%)

Nëse bëhet krahasimi me rezultatet për stereotipet të cilët maqedonasit dhe shqiptarët ndërtojnë për vete (autostereotipet) dhe njëri për tjetrin (heterostereotipe), këtë mund ta shohim nga gjendjet e prezantuara në Tabelën 3 dhe Tabelën 4. Veçoritë e prezantuara në tabelat në fjalë mund të ndahen në tre grupe: 1. Heroiko-liridashëse (të guximshëm, luftarakë, krenarë, dëshirojnë të sundojnë, e ngjashëm), 2. Kulturore (përparimtarë, të prapambetur, punëtorë, përtacë, të papastër, të sjellshëm, e ngjashëm) dhe 3. Bashkëvepruese (mikpritës, gazmorë, egoistë, e ngjashëm). Këto grupe mund të plotësohen me diferencialin semantik të Osogood, i cili stereotipet vështron nga aspekti i vlerësimit (të mirë – të këqinj), i fuqisë (potencës, të fuqishëm – të dobët) dhe i aktivitetit (aktivë - pasivë) (Tashevska, 2004). Nëse shqyrtojmë stereotipet që Maqedonasit ndërtojnë për vete, mund të vërehen të gjitha grupet e stereotipeve, por nëse në të kaluarën kanë mbizotëruar konceptet kulturore, mund të vërehet lëvizja në drejtim të veçorive heroiko-liridashëse. Sa iu përket heterostereotipeve ndaj komunitetit shqiptar, mbizotëron niveli kulturor i stereotipeve si stereotipe heroiko-liridashëse në hulumtimet e viteve 1995 dhe 2003 respektivisht. Në lidhje me këtë të fundit, e kemi patjetër të vërejmë se në vitin 2015 shënohet një lëvizje e konsiderueshme, meqë si stereotipi i parë më i rëndësishëm ndaj grupit shqiptar është stereotipi që ka domethënie pozitive heroiko-liridashëse. Lidhur me autostereotipet tek shqiptarët mbizotërojnë stereotipet pozitive heroiko-liridashëse, por gjithashtu janë përfaqësuar dhe ato kulturore, përderisa tek heterostereotipet ndaj komunitetit maqedonas, ekzistojnë stereotipe negative heroiko-liridashëse, por dhe stereotipe negative kulturore dhe bashkëvepruese. Edhe krahas lëvizjes së lehtë në vitin 2015, në raport me dy hulumtimet paraprake, prapseprap mund të konstatojmë se akoma po ekziston konkurrueshmëria dhe paralelizmi në lidhje me ndërtimin e stereotipeve midis dy komuniteteve më të mëdha në vend, gjë kjo e cila tregon për komunikimin pamjaftueshëm të zhvilluar midis individëve në komunitetet, gjë kjo e cila akoma po krijon parakushte për një shoqëri të segreguar. Gjithashtu, paragjykimet e këtyre dy grupeve kanë veçori paternaliste dhe komponentin konkurrues që janë të shprehura në mënyrë të fuqishme. E para ka të bëjë me një tension të theksuar negativ kur bëhet fjalë për veçoritë e vlerave dhe nivelit kulturor të të "Tjetrit", kurse e dyta tregon për marrëdhëniet konkurruese midis grupeve etnike, nxitur nga ndjenja e rrezikimit dhe qasja e kufizuar në resurset shoqërore.

Tabela 3

MAQEDONASIT						
	1995		2003		2015	
Lloji i pasqyrës	Maqedonasit për vete (autostereotipi)	Maqedonasit për shqiptarët (heterostereotipi)	Maqedonasit për vete (autostereotipi)	Maqedonasit për shqiptarët (heterostereotipi)	Maqedonasit për vete (autostereotipi)	Maqedonasit për shqiptarët (heterostereotipi)
Veçoria 1	krenarë	të vonuar	të mirë	agresivë	të guximshëm	të guximshëm
Veçoria 2	mikpritës	të pakulturuar në sjellje	që lëshojnë pe (tolerues)	të pakulturuar në sjellje	krenarë	të pakulturuar në sjellje
Veçoria 3	të guximshëm	të vrazhdë	pasivë	të vrazhdë	punëtorë	të harmonishëm
Veçoria 4	punëtorë	nuk duan kombe tjera	që lëshojnë pe (tolerues)	dëshirojnë të sundojnë	mikpritës	të vrazhdë
Veçoria 5	zemerbardhë	kontrabandistë	zemerbardhë	kontrabandistë	gazmorë	dëshirojnë të sundojnë

Tabela 4

SHQIPTARËT						
	1995		2003		2015	
Lloji i pasqyrës	Shqiptarët për vete (autostereotipi)	Shqiptarët për Maqedonasit (heterostereotipi)	Shqiptarët për vete (autostereotipi)	Shqiptarët për Maqedonasit (heterostereotipi)	Shqiptarët për vete (autostereotipi)	Shqiptarët për Maqedonasit (heterostereotipi)
Veçoria 1	të guximshëm	nuk duan kombe tjera	të guximshëm	nuk duan kombe tjera	të guximshëm	të vrazhdë
Veçoria 2	krenarë	egoistë	luftarakë	egoistë	krenarë	nuk duan kombe tjera
Veçoria 3	mikpritës	të vrazhdë	krenarë	pasivë	zemerbardhë	egoistë
Veçoria 4	punëtorë	frikacakë	punëtorë	frikacakë	mikpritës	dëshirojnë të sundojnë
Veçoria 5	përtacë	të harmonishëm	të harmonishëm	zemerligë	luftarakë	ziliqarë

2.8. Distanca etnike

Në pyetjen e radhës, anketuesit duheshte t'i radhitin grupet e ofruara: shqiptarë, maqedonas, romë, serbë dhe turq, me numrin rendor nga 1 deri 5, me të cilën radhitje me 1 do ta kishin shënuar grupin që e ndiejnë më të afërt, kurse me 5 do ta kishin shënuar grupin që e ndiejnë si më të largët. Nga rezultatet mund të konstatohet se të anketuarit maqedonas dhe shqiptar po ndërtojnë një distancë, por kjo gjë është shumë më e shprehur si distancë të cilën ndërtojnë maqedonasit ndaj shqiptarëve, ndërsa më e vogël është distanca që shqiptarët ndërtojnë ndaj maqedonasve. Ajo që është e dukshme është se komuniteti rom gjendet në vendin e katërt sipas qëndrimeve të të anketuarve maqedonas, por dhe sipas qëndrimeve të të anketuarve shqiptarë. Përqindjet e ofruara shenojnë se sa përqind të të anketuarve (maqedonas ose shqiptarë) kanë shënuar grupin në fjalë në vendin ku iu përshkruhet (Tabela 5).

Tabela 5


MAQEDONASIT	Maqedonasit (83,3 %)	Serbët (66,7 %)	Turqët (48 %)	Romët (30,4 %)	Shqiptarët (39,5 %)
SHQIPTARËT	Shqiptarët (86,5 %)	Turqët (48,7 %)	Maqedonasit (37,2 %)	Romët (42,9 %)	Serbët (52,6 %)

Shkalla e preferencës ndërpersonale etnike është përdorur për të konstatuar dimensionin subjektiv të bashkëveprimit, gjegjësisht, ndjenjën e afërsisë dhe distancës së pjesëtarëve të komuniteteve etnike në vend. Në Tabelën 6 janë prezantuar rezultatet e pyetjes ku nga të anketuarit është kërkuar t'i radhitin grupet sipas afërsisë që ndiejnë ndaj secilit grup. Niveli i koeficientit të afërsisë është përcaktuar me një shtrirje numerike nga 1-5, ku 1 shënon distancën më të madhe, kurse 5 afërsinë më të madhe. Kështu, në mënyrë krahasuese janë prezantuar rezultatet e hulumtimeve të bëra në vitet 1995, 2003 dhe 2015. Nga të dhënat e prezantuara, mund të vërehet se koeficienti i distancës etnike, parimisht midis komunitetit etnik maqedonas dhe atë shqiptar është më i lartë në periudhën pas konfliktit, në vitin 2003. Nga të gjitha rezultatet, është e dukshme se distanca etnike është e lidhur ngushtë me përkatësinë konfesionale të grupeve, me përjashtim të vogël në lidhje me komunitetin etnik turk, ku konstanta është më stabile si tek perceptimet e të anketuarve maqedonas, ashtu dhe tek perceptimet e të anketuarve shqiptarë. Gjithashtu, distanca etnike në perceptimet e të anketuarve shqiptarë është më e ulët në lidhje me grupin etnik maqedonas, kurse distanca të cilën të anketuarit maqedonas ndërtojnë ndaj grupit etnik shqiptar është për një nuancë më e lartë. Përjashtim të konstatimit të këtillë bëjnë rezultatet e hulumtimit të vitit 2003. Ajo që inkurajon dhe duhet të vërehet është se, edhe pse jo në një shtrirje të madhe, distanca etnike në hulumtimin e fundit të vitit 2015 është më e ulët, në raport me hulumtimet e mëhershme. Kjo gjë posaçërisht është shprehur në sjelljen e grupit etnik maqedonas ndaj grupit etnik shqiptar, ku nga distanca maksimale në vitin 2003 dhe indeksin 1,07, kemi një ndjenjë më të madhe të afërsisë në vitin 2015, respektivisht, indeksin 3,18. Edhe pse indeksi i këtillë është më i vogël tek perceptimet për komunitetin etnik shqiptar në lidhje me afërsinë me komunitetin etnik maqedon, prapseprap edhe këtu ekziston një lëvizje pozitive, nga 1,12 në vitin 1995 dhe distanca maksimalisht e mundur 1 në vitin 2003, e deri në afrimin në 1,98 në vitin 2015. Ose, gjithsej, nga hulumtimi i fundit në vitin 2015, në kuadër të perceptimeve të të anketuarve maqedonas dhe shqiptarë, vërehet një trend i rënies së distancës etnike në marrëdhëniet e ndërsjella, por edhe në sjelljen e tyre që ndërtojnë ndaj grupeve tjera etnike. Përjashtim bën vetëm distanca etnike që maqedonasit ndërtojnë në lidhje me grupin etnik serb, dhe e cila në hulumtimet e mëhershme ka një margjinë më të ulët, sidomos në vitin 2003, kur arrin 4,78, por megjithatë, në këtë hulumtim të fundit shfaqet një trend i qartë i rritjes së distancës së këtillë dhe ajo në vitin 2015 arrin vlerën 3,68. E gjithë kjo, edhe krahas distancës akoma ekzistuese të lartë etnike midis dy komuniteteve më të mëdha etnike në vend, prapseprap tregon për një përmirësim gradual të marrëdhënieve ndëretnike në vend, gjegjësisht, tregon për një tendencë të qartë të pakësimit të distancës së tillë (Grafiku 19 dhe Grafiku 20).


Tabela 6

	PËRKATËSIA ETNIKE					
	Maqedone			Shqiptare		
	1995	2003	2015	1995	2003	2015
Maqedonasit	4,87	4,92	4,73	2,24	1,07	3,18
Shqiptarët	1,12	1	1,98	4,88	5,00	4,92
Turqët	2,34	2,30	2,70	3,67	3,70	3,51
Romët	1,54	1,23	2,02	1,35	1,30	2,06
Serbët	4,34	4,78	3,68	1,02	1	1,44

Grafiku 19



Grafiku 20



Në vendin tonë, së bashku jetojnë pjesëtarë të grupeve etnike dhe të feve të ndryshme. Ajo që na intereson ne si pjesë e hulumtimit është cilat nga marrëdhëniet e numëruara, të anketuarit do të kishin patur dëshirë t'i kanë me pjesëtarin e rëndomtë, as më të mirin, e as më të keqin, të komunitetit të caktuar etnik ose të fesë së caktuar etnike. Kështu, në Tabelat që vijojnë (Tabela 7, 8, 9 dhe 10) janë prezantuar qëndrimet e të anketuarve me hulumtimin empirik të zbatuar në vitin 2015. Pyetjet kanë të bëjnë me distancën ndërpersonale etnike dhe fetare (Qëndrimet “Të shoqërizohem me të dhe të jetë miku im” dhe “Motra ime/vëllau im ose familjari im të martohet me të”), distanca etnike dhe fetare në lidhje me zonën e banimit (“Të banojë me mua në të njëjtën komunë” dhe “Të banojë me mua në të njëjtën zonë”), distanca etnike në lidhje me pozitën (“Të jetë kryetar komunë në komunën ku banoj”, “Ta përfaqësojë Komunën në Kuvend dhe “Të jetë udhëheqës në organizatën për të cilën punoj”), si dhe distanca arsimore (“Fëmijët e tij të vizitojnë shkollën e njëjtë si fëmijët e mi”). Me këtë, një pjesë e qëndrimeve kanë të bëjnë me përdorimin e së ashtuquajturës Shkalla e Bogardusit e matjes së distancës etnike.

Në lidhje me distancën ndërpersonale, vërehet një distancë e cila është për një nuancë më e vogël nga komuniteti etnik maqedonas ndaj të tjerëve, nëse krahasojmë qëndrimet e të anketuarve nga komuniteti etnik shqiptar. Është interesante të shënohet se, edhe pse dallimi është minimal, barriera fetare në kuadër të marrëdhënieve ndërpersonale midis grupeve etnike jo çdoherë është vendimtare. Kështu, për shembull, distanca etnike tek të anketuarit nga grupi etnik maqedon, në lidhje me komunitetin turk është më e vogël se distanca ndërpersonale, të cilën manifestojnë drejt atij të anketuarit nga komuniteti etnik shqiptar. Të ngjashme janë marrëdhëniet korelative ndërpersonale edhe në perceptimet e të anketuarve nga dy komunitetet më të mëdha konfesionale (ortodokse-krishtere dhe islame), me të cilën distanca ndërpersonale e të anketuarve nga komuniteti ortodoks-i krishter ndaj të tjerëve është më e vogël, nëse krahasojmë të njëjtën distancë që kanë të anketuarit të konfesionit islam.

Kur flasim për distancën etnike në lidhje me zonën e banimit, e kemi patjetër të vërejme qëndrime të ngjashme tek dy komunitetet dominuese etnike në vend, me një vërejtje se distanca është konsiderueshëm më e madhe në drejtim të grupit etnik rom edhe atë serb. Sa i përket distancës fetare, është i dukshëm një distancim më i madh i pjesëtarëve të komunitetit islam në raport me konfesionet tjera, nëse krahasojmë me qëndrimet që mbajnë të anketuarit e konfesionit krishter-ortodoks në raport me të tjerët. Një pasqyrë të ngjashme mund të vërejmë edhe në raport me distancën etnike dhe fetare lidhur me pozitën dhe distancën arsimore.

Nga raportet e prezantuara në prezantimet tabelare, Tabela 7-10, mund të vërejmë se margjina më e madhe e distancës etnike tek të anketuarit maqedonas është në lidhje me distancën ndërpersonale në drejtim të komunitetit etnik rom, gjegjësisht, distanca më e madhe pushon në qëndrimin “Motra ime ose një anëtare e familjes sime u martua me të”, ku preferenca ndaj komunitetit etnik rom është vetëm 8,2%. Aq më tepër, tek të anketuarit shqiptarë, etnocentrizmi është shprehur më fuqishëm, dhe kjo gjë mund të vërehet nga distanca fuqishëm e shprehur etnike në drejtim të komunitetit etnik rom dhe atë serb në të gjitha bazat, apo distanca etnike bëhet edhe në bazë ndërpersonale, distanca etnike fuqishëm e shprehur në lidhje me zonën e banimit, pozitën, si dhe distanca arsimore. Më fuqishëm është e shprehur distanca etnike ndërpersonale në drejtim të komunitetit rom, ku për konstatimin “Motra ime apo anëtarja e familjes sime të martohet me të”, janë përcaktuar vetëm 1,9% nga të anketuarit shqiptarë. Arsyet e qëndrimit të këtillë ndaj komunitetit rom duhet të kërkohen, edhe krahas afërsisë për sa i përket përkatësisë konfesionale, në stigmatizimin tradicional fuqishëm të shprehur të komunitetit rom, dhe në lidhje me komunitetin serb, ku ai konsiderohet të jetë rivali më i madh etnik, dhe me vetë këtë – kërcënim për komunitetin shqiptar. Në lidhje me komunitetin etnik maqedonas, nga qëndrimet e të anketuarve shqiptarë, më e madhe është distanca ndërpersonale. Për shembull, 12% nga maqedonasit do të ishin pajtuar që motra e tyre ose e afërmja e tyre të martohet me një shqiptar, kurse përqindja e shqiptarëve ndaj maqedonasve për të njëjtën pyetje është vetëm 3,8%. Por, e kemi patjetër të shenojmë se qëndrimi i dytë i cili ka të bëjë me distancën ndërpersonale, “Të shoqërizohem me të dhe të jetë miku im”, vetë distanca etnike është më e vogël në marrëdhëniet korelative të maqedonasve, shqiptarëve dhe turqëve. Veç kësaj, tek grupet e njëjta, më e vogël është dhe distanca arsimore.

Në lidhje me përkatësinë fetare, të anketuarit e fesë krishtere-ortodokse, si dhe ata të fesë islame kanë distancë në raport me konfesionin protestant. Distanca fetare midis të krishterëve ortodoks dhe të anketuarve të konfesionit islam është në bazë të distancës ndërpersonale fetare, gjegjësisht në qëndrimin “Motra ime ose e afërmja ime të martohet me të”. Domethënë, në lidhje me konfesionin krishter-ortodoks vetëm për 7% të të anketuarve të konfesionit islam kjo gjë është e pranueshme dhe përkundrazi, kjo përqindje tek të anketuarit ortodoks ndaj të anketuarit e fesë islame është 19% (Tabela 9 dhe 10).

Tabela 7

MAQEDONASIT

	MAQEDONASI	SHQIPTARI	TURKU	ROMI	SERBI
Të banojë në të njëjtën komunë si unë	89, 8 %	31, 3 %	39, 8 %	34, 6 %	58, 5 %
Të banojë në të njëjtën zonë si unë	86 %	24, 9 %	34, 2 %	19, 3 %	54, 1 %
Fëmijët e tij të vizitojnë shkollën e njëjtë si fëmijët e mi	84, 8 %	31, 3 %	43 %	29, 2 %	57, 9 %
Të shoqërizohem me të dhe të jetë miku im	84, 8 %	35, 4 %	50 %	28, 7 %	65, 2 %
Motra ime ose e afërmja ime të martohet me të	86, 3 %	12 %	16, 4 %	8, 2 %	41, 5 %
Të jetë kryetar i komunës ku banoj	90, 1 %	15, 2 %	15, 8 %	10, 8 %	24 %
Të jetë udhëheqës në organizatën për të cilën punoj	89, 2 %	21, 3 %	27, 2 %	15, 8 %	35, 4 %
Ta përfaqësojë komunën time në Kuvend	89, 5 %	16, 1 %	18, 4 %	11, 1 %	26, 6 %

Tabela 8

SHQIPTARËT

	MAQEDONASI	SHQIPTARI	TURKU	ROMI	SERBI
Të banojë në të njëjtën komunë si unë	23, 1 %	84 %	37, 8 %	7, 7 %	7, 7 %
Të banojë në të njëjtën zonë si unë	15, 4 %	88, 5 %	32, 1 %	5, 8 %	4, 5 %
Fëmijët e tij të vizitojnë shkollën e njëjtë si fëmijët e mi	20, 5 %	84, 6 %	30, 1 %	5, 1 %	6, 4 %
Të shoqërizohem me të dhe të jetë miku im	27, 6 %	80, 8 %	37, 8 %	5, 8 %	5, 8 %
Motra ime ose e afërmja ime të martohet me të	3, 8 %	91 %	14, 1 %	1, 9 %	2, 6 %
Të jetë kryetar i komunës ku banoj	11, 5 %	87, 2 %	15, 4 %	6, 4 %	5, 1 %
Të jetë udhëheqës në organizatën për të cilën punoj	17, 3 %	86, 5 %	18, 6 %	6, 4 %	8, 3 %
Ta përfaqësojë komunën time në Kuvend	17, 3 %	86, 5 %	16 %	5, 8 %	7, 1 %

Tabela 9

KONFESIONI I KRISHTER ORTODOKS

	ORTODOKSI	MUSLIMANI	KATOLIKU	PROTESTANTI
Të banojë në të njëjtën komunë si unë	89, 5 %	46, 7 %	50, 2 %	32, 5 %
Të banojë në të njëjtën zonë si unë	90, 1 %	38, 4 %	44 %	27, 9 %
Fëmijët e tij të vizitojnë shkollën e njëjtë si fëmijët e mi	87 %	43, 7 %	46, 4 %	31 %
Të shoqërizohem me të dhe të jetë miku im	89, 5 %	43, 3 %	47, 7 %	30, 3 %
Motra ime ose e afërmja ime të marrohet me të	90, 4 %	19, 8 %	26, 9 %	17 %
Të jetë kryetar i komunës ku banoj	90, 1 %	25, 4 %	31 %	21, 1 %
Të jetë udhëheqës në organizatën për të cilën punoj	90, 4 %	28, 5 %	30, 3 %	21, 7 %
Ta përfaqësojë komunën time në Kuvend	85, 8 %	25, 1 %	29, 4 %	18, 9 %

Tabela 10

KONFESIONI ISLAM

	ORTODOKSI	MUSLIMANI	KATOLIKU	PROTESTANTI
Të banojë në të njëjtën komunë si unë	24 %	93 %	18 %	10, 5 %
Të banojë në të njëjtën zonë si unë	19, 2 %	91, 3 %	16, 3 %	7, 6 %
Fëmijët e tij të vizitojnë shkollën e njëjtë si fëmijët e mi	23, 3 %	89 %	16, 3 %	10, 5 %
Të shoqërizohem me të dhe të jetë miku im	23, 3 %	84, 9 %	18, 6 %	8, 1 %
Motra ime ose e afërmja ime të marrohet me të	7 %	87, 8 %	4, 1 %	2, 3 %
Të jetë kryetar i komunës ku banoj	17, 4 %	88, 4 %	14 %	8, 1 %
Të jetë udhëheqës në organizatën për të cilën punoj	16, 9 %	87, 2 %	10, 5 %	5, 8 %
Ta përfaqësojë komunën time në Kuvend	23, 8 %	83, 7 %	14 %	7, 6 %

2.9. Shkalla e lidhshmërisë me përkatësinë në grup – Shkalla e Likertit

Në pjesën në vijim, me përdorimin e të ashtuquajturës Shkalla e Likertit për matjen e qëndrimeve, do të prezantohen qëndrimet e të anketuarve që përmbajnë komponente të lidhshmërisë së individit me një grup të caktuar etnik, ose të pikëpamjes për lidhshmëri etnike. Kështu, do të bëhet krahasimi me rezultatet e hulumtimit të zbatuar në vitin 2015, me hulumtimet e zbatuara për të njëjtat çështje në vitet 1995 dhe 2003 (Tabela 11).

Sipas ndarjes së N. Rot dhe N. Havellka, ekzistojnë tre lloje të lidhshmërisë kombëtare-etnike:

1. Lidhshmëria e jashtëzakonshme kombëtare-etnike (e cila karakterizohet me përkushtim të theksuar ndaj kombit ose grupit të vet etnik, si grupi i vetëm që është i rëndësishëm, dhe i përgjigjet asaj që zakonisht quhet etnocentrizëm, nacionalizëm ose etnonacionalizëm);
2. Përkatësia e theksuar kombëtare-etnike (e cila karakterizohet me përkushtim të theksuar ndaj kombit të vet, por dhe me pranimin e ekzistimit të përkushtimeve të tjera grupore – i përgjigjet idealizimit kombëtar dhe etnik ose patriotizmit); dhe

3. Lidhshmëria e shumëfishtë kombëtare-etnike (që karakterizon përkushtimin ndaj kombit dhe grupit etnik të vet, si dhe ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar dhe dakordimit, e cila gjë është e njohur si internacionalizëm) (Tashevskaja, 2004).

Për përcaktimin e shkallës së përkushtimit ndaj grupit vetjak etnik ose kombëtar, është përdorur shkalla e cila përmban nëntë qëndrime. Në pjesën e përgjigjeve, është ofruar një shkallë pesë-anëshe në të cilën 1 shënon pajtimin më të lartë, dhe 5 mospajtimin e plotë me pretendimin e ofruar. Në gjithë tre hulumtimet (të viteve 1995, 2003 dhe 2015) është përdorur po e njëjta shkallë e qëndrimeve, nga të cilët më poshtë, në Tabelën 11 është paraqitur një indeks i cili bazohet në mesin aritmetik të qëndrimeve. Këtu janë ofruar qëndrimet në vijim:

1. Secili komb duhet patur shtetin e vet;
2. Martesat etnikisht të përziera janë dënuar për dështim;
3. Dikush mund të ndjehet i sigurt në rrethin e tij vetëm kur shumica e atyre që janë në afërsinë e tij i takojnë komunitetit të njëjtë etnik;
4. Mund të arrihet bashkëpunimi midis komuniteteve etnike, por jo dhe besimi i plotë;
5. Secili duhet të ndiejë se fati i kombit të tij është fati i tij personal;
6. Unë ndiej të njëjtën shkallë të përkatësisë edhe ndaj kombit tim, edhe ndaj njerëzimit;
7. Ndjenja e përkatësisë kombëtare-etnike është njëra nga ndjenjat më të mira;
8. Është e pandjeshme të thuhet se gjithë komunitetet kombëtare-etnike janë të barabarta, kur është evidente se shumica nga ato janë më të vlefshme se tjerat;
9. Ata që i takojnë kombit tim do të duhet më tepër ta vlerësojnë kombin e vet.

Tabela 11

Qëndrimet	PËRKATËSIA ETNIKE					
	Maqedone			Shqiptare		
	1995	2003	2015	1995	2003	2015
	mesit aritmetik	mesit aritmetik	mesit aritmetik	mesit aritmetik	mesit aritmetik	mesit aritmetik
1.	2,61	2,54	2,42	1,96	1,12	1,69
2.	3,39	3,02	3,21	2,10	2,00	2,34
3.	3,00	1,87	2,78	2,29	1,87	1,99
4.	2,32	2,00	2,57	2,13	1,94	2,08
5.	2,35	2,20	2,79	2,03	1,79	2,04
6.	2,07	1,76	1,94	1,93	1,46	2,13
7.	2,59	3,00	2,34	1,99	1,85	1,65
8.	3,06	3,24	2,79	2,42	2,06	2,08
9.	2,67	2,53	2,40	2,11	1,94	1,82

Nga të dhënat e prezantuara në Tabelën 11, mund të vërehet një dallim i caktuar në perceptimet e maqedonasve dhe shqiptarëve në vend. Niveli më i fuqishëm i mospajtimit tek maqedonasit ka të bëjë me pretendimin se “Martesat etnikisht të përziera janë të dënuara për dështim”, ku mund të vërehet një përjashtim minimal në periudhën pas konfliktit, i cili ec në drejtim të pavendosmërisë, por në periudhën para konfliktit, në vitin 1995 dhe në vitin 2015, indeksi po rritet, gjë kjo e cila tregon për një lëvizje nga pavendosmëria drejt mospajtimit. Edhe pse indeksi është më i vogël, trendi i njëjtë mund të vërehet edhe tek të anketuarit shqiptarë. Kështu, në periudhën pas konfliktit, pra, në vitin 2003 po vërejmë një pajtim, në periudhën para konfliktit, si dhe në hulumtimin e vitit 2015, ekziston një lëvizje e qëndrimeve nga pajtimi në pavendosmëri. Kjo pyetje tregon se edhe krahas segregimit të qartë shoqëror të dy komuniteteve më të mëdha, prapëseprap ekziston një lëvizje në drejtim të tolerimit të dallimeve, madje edhe në segmentin më të ndjeshëm shoqëror, siç janë martesat etnikisht të përziera, dhe me këtë tregon për mundësinë e tolerancës ndëretnike.


Indeksi më i ulët tek maqedonasit është vërejtur në lidhje me pyetjen e gjashtë, ku janë kombinuar centrizmi dhe universalizmi të cilat, edhe pse në shikim të parë është evidente se nuk mund të kombinohen, prapsepap mundësia e këtyllë lidhet me nivelin e abstrahimit, në të cilin kombi është konkret, ndërsa njerëzia është një kategori abstrakte.

Lëkundje të qarta tek maqedonasit mund të vërejmë edhe tek pyetjet 7 dhe 8, të cilat kanë të bëjnë me pëlqimin për superioritetin e grupit dhe qëndrimin emocional ndaj kombit vetjak. Mund të vërehet qartë se këto ndjenja po biejnë në periudhën pas konfliktit, në hulumtimin e vitit 2003, kurse me hulumtimin e fundit të vitit 2015, indeksi është më i ulët, madje edhe nga ai i periudhës para konfliktit, duke u lëvizur nga pajtimi, dhe tregon për fuqizimin e etnocentrizmit ose nacionalizmit tek grupi shumicë në vend.

Gjithashtu, mund të vërehet një tendencë e qartë tek të anketuarit maqedonas në lidhje me pyetjet 1 dhe 9, në të cilat ekziston tendenca e lëvizjes së vazhdueshme nga pavendosmëria në pajtim. Kjo gjë përsëri ka të bëjë me konstatimin e mëhershëm, gjegjësisht, se, edhe pse në mënyrë të lehtë, ekziston një tendencë e qartë e fuqizimit të ndjesisë anëtarëve të perkatesisë etnike maqedonase, madje deri në shkallë që të ndjeheni më të sigurt në kuadër të komunitetit të vet. Por, e kundërta nga kjo, tek maqedonasit mund të vërehet ndjesia më e fuqishme e identifikimit të fatit me kombin në vitin 2003, kurse në ditët tona ky qëndrim po lëviz nga pajtimi drejt pavendosmërisë (Grafiku 21).


Grafiku 21

Shkalla e Likertit
Maqedonasit



Nëse bëjmë krahasimin me qëndrimet e të anketuarve maqedonas, tek të anketuarit shqiptarë, në Tabelën 11 qartë mund të vërehet etnocentrizmi më i shprehur i grupit, i cili më së shpeshti lëviz mes intervaleve të pajtimit dhe pajtimit të plotë. Tendencat tek shqiptarët gjithashtu përputhen me tendencat e maqedonasve. Kështu, tek pyetja 6 ekziston një lëvizje e lehtë drejt universalizmit, gjegjësisht nga pajtimi, një lëvizje e lehtë drejt pavendosmërisë. Tek pyetjet 7 dhe 8, të cilat kanë të bëjnë me pajtimin për superioritetin e grupit vetjak dhe qëndrimin emocional ndaj kombit vetjak, kemi një lëvizje drejt pajtimit, gjegjësisht, pajtimin të plotë. Lëvizje më të madhe tek shqiptarët kemi në lidhje me pyetjen e dytë, ku ka lëvizje nga pajtimi drejt pavendosmërisë, gjë kjo e cila tregon për evoluimin gradual të qëndrimeve në kuptimin e pranimit të dallimeve, të reflektuara në tendencën e lehtë të pranimit të martesave etnikisht të përziera. Edhe pse, dëshira për vlerësimin më të lartë të kombit vetjak po rritet, siç është prezantuar me qëndrimet në lidhje me pyetjen e nëntë, tek e cila ekziston tendenca e vazhdueshme të fuqizimit të pranimit, prapsepap tek të anketuarit shqiptarë ekziston rritja e indeksit tek pyetja e parë, e cila qartë po rritet, sidomos në krahasim me periudhën pas konfliktit ajo po lëviz nga pajtimi i plotë drejt pajtimit (Grafiku 22).

Grafiku 22
Shkalla e Likertit
Shqiptarët




Analiza e këtillë e qëndrimeve është mbështetur plotësisht me qëndrimet e të anketuarve lidhur me çështje që kanë të bëjnë me identifikimin e grupeve me nivelet e ndryshme të lidhshmërisë, nga komuniteti lokal e deri tek universalizmi dhe lidhshmëria me mjedisin global. Në këtë pyetje janë renditur grupet të cilave u takojnë të anketuarit. Ndërkaq, me rrethimin e njërës nga mundësitë (shumë e rëndësishme, mesatarisht e rëndësishme, pak e rëndësishme, e parëndësishme fare), të anketuarit përcaktohen për atë se sa përkatësia në secilin nga këto grupe është e rëndësishme për ata. Kështu, indeksi është nxjerrë me një mes aritmetik të qëndrimeve, ku 1 është shumë e rëndësishme, përdërisa 4 është e parëndësishme fare. U ofruan grupet në vijim: qyteti/fshati, rajoni, kombësia, feja, profesioni, shteti, Ballkani, Evropa dhe bota/njerëzimi.

Nga rezultatet e prezantuara në Tabelën 12 dhe Grafikon 23, mund të vërejmë se më e rëndësishme për maqedonasit dhe shqiptarët është ndjenja e përkatësisë ndaj kombësisë, e cila tek maqedonasit lehtë po lëviz nga mesatarisht e rëndësishme në shumë e rëndësishme, kurse tek shqiptarët më tepër prinë drejt alternativës shumë e rëndësishme. Kjo gjë tregon për etnocentrizmin e fuqishëm të shoqërisë maqedonase. Përkatësia fetare, respektivisht, feja, tek të anketuarit shqiptarë është barabartësisht njëjtë e rëndësishme si dhe përkatësia kombëtare-etnike, kurse nga qëndrimet e të anketuarve maqedonas, ajo është mesatarisht e rëndësishme dhe lehtë po lëviz drejt alternativës pak e rëndësishme. Ajo që befason këtu nga rezultatet është rëndësia të cilën të anketuarit shqiptarë ia japin mjedisit lokal (qytetit/fshatit) dhe sidomos profesionit. Kjo gjë mund të sqarohet me tradicionalizmin e fuqishëm tek ky komuniteti, si dhe tradicionalisht inkorporimi i pamjaftueshëm në sektorin shtetëror ose në kompanitë e mëdha, apo më saktësisht, lidhshmëria me biznesin familjar, si vegla elementare e organizimit ekonomik të këtij komuniteti. Më pak të rëndësishme për të dy komunitetet janë ndjenjat e përkatësisë të cilat i ndërtojnë për shtetin dhe rajonin më të gjerë të Ballkanit. Duket problematike rëndësia më e ulët e cila i jepet shtetit, dhe lëviz nga kalimi i mesatarisht e rëndësishme drejt pak e rëndësishme, sidomos tek komuniteti etnik maqedon, i cili atë e përjeton si shtetin e vet kombëtar (Tabela 12 dhe Grafiku 23).

Tabela 12

Qëndrimet	PËRKATËSIA ETNIKE	
	Maqedone	Shqiptare
	2015	2015
	mesi aritmetik	mesi aritmetik
1. qyteti/fshati	2,06	1,70
2. rajoni	2,20	1,80
3. kombësia	1,98	1,41
4. konfesionit fetar	2,14	1,40
5. profesioni	2,24	1,59
6. shteti	2,25	2,15
7. Ballkani	2,30	2,17
8. Evropa	2,11	2,04
9. bota/njerëzimi	2,03	1,94

Grafiku 23



III. GJETJET NGA HULUMTIMI I DISKRIMINIMIT, GJUHËS SË URREJTJES DHE KRIMIT NGA URREJTJA

Në këtë pjesë të hulumtimit veçmas po përpunohen perceptimet e të anketuarve lidhur me tre dukuritë në shoqëri: *e para*, diskriminimi, *e dyta*, gjuha e urrejtjes dhe *e treta*, krimi nga urrejtja.

3.1. Diskriminimi

Kjo pjesë e hulumtimit kishte për qëllim ekzaminimin e perceptimit të qytetarëve në moshë nga 16 deri 24 vjeç, për dy temat në vijim: *e para*, perceptimi i përfaqësimit të secilit lloj të diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike, gjinisë, orientimit seksual, moshës, fesë ose bindjes, hendikepit dhe përkatësisë politike; dhe *e dyta*, lufta kundër diskriminimit, respektivisht masat ekzistuese të cilat po i ndërmerret shteti në këtë fushë. Të dhënat po shqyrtohen dhe po komentohen së bashku me pyetjet për qëndrimet e shprehura në lidhje me pranimin e dallimeve nga pjesa e parë e hulumtimit, siç janë sqaruar më lartë, gjegjësisht, vendosja e vetvetes në ambientin e diversitetit social dhe vetëperceptimi i përkatësisë ndaj një grupi të caktuar.

3.1.1. Perceptimi për diskriminimin

Perceptimi për diskriminimin është jashtëzakonisht i rëndësishëm si nga aspekti i mbrojtjes së të drejtave vetjake, ashtu dhe nga aspekti i shmangies së sjelljes diskriminuese, mirëpo këtu përfshihet dhe njohja e sjelljes së këtyre kur bëhet fjalë për shkëlqen e të drejtave të të tjerëve dhe gatishmëria për të reaguar ndaj këtyre situatave. Perceptimi për diskriminimit është posaçërisht i lidhur me njohuritë, informimin, por dhe zhvillimin e shkathtësive të posaçme (zhvillimi i “receptorëve” për diskriminimin) dhe me ndërtimin e kulturës së mosdiskriminimit (Petroska Beshka, Najčevska, 2009, fq. 69).

Në pyetjen **Sa e shpesh është secila nga format e numëruara të diskriminimit?**, të anketuarit duhej të përcaktoheshin për nivelin e ekzistimit të diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike, gjinisë, orientimit seksual, moshës, fesë ose bindjes, hendikepit (hendikepi mendor dhe trupor) dhe në bazë të përkatësisë politike. Gjatë kësaj, u ofruan disa përgjigje alternative, si këto në vijim: nuk ekziston, është shumë i rrallë, mjaftë i rrallë, mjaftë i shpeshtë dhe shumë i shpeshtë, të cilat pasqyrojnë shkallën nga 1 deri 5, ku 1 është niveli më i ulët i ekzistimit të diskriminimit në bazën përkatëse, dhe 5 është niveli më i lartë i ekzistimit të diskriminimit. Në Tabelë prodhohet indeksi i cili është rezultat i mesit aritmetik nga përgjigjet e fituara, ku indeksi më i lartë shënon pajtimin më të lartë me ekzistimin e diskriminimit në lidhje me bazën përkatëse. Gjatë procesimit të të dhënave në bazë të përkatësisë etnike dhe fetare, janë analizuar vetëm të dhënat mbi dy komunitetet më të mëdha etnike dhe fetare në vend.

Sipas rezultateve të hulumtimit, perceptimi i ekzistimit të diskriminimit është akoma tepër më i përhapur se perceptimi se diskriminimi mungon (Tabela 13). Format e diskriminimit për të cilat pretendohet se janë më të shpeshta janë diskriminimi në bazë të përkatësisë politike dhe në bazë të përkatësisë etnike, të vijuar nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual, të fesë ose bindjes dhe në bazë të hendikepit. Niveli më i ulët i diskriminimit vërehet tek bazat: gjini dhe moshë.

Tabela 13

DISKRIMINIMI							
Baza	Gjithsej	Gjinia		Përkatësia etnike		Përkatësia fetare	
		Mashkullore	Femërore	Maqedone	Shqiptare	Ortodokse	Islame
Përkatësia etnike	3,77	3,69	3,84	3,70	3,97	3,70	3,94
Gjinia	2,85	2,63	3,07	2,78	3,03	2,75	3,10
Orientimi seksual	3,74	3,62	3,86	3,92	2,90	3,93	3,03
Mosha	2,74	2,78	2,70	2,74	2,69	2,72	2,73
Feja ose bindja	3,50	3,54	3,46	3,50	3,42	3,50	3,37
Hendikepi	3,39	3,19	3,59	3,47	3,13	3,44	3,12
Përkatësia politike	4,11	4,05	4,17	4,11	4,12	4,11	4,10

Perceptimi për mungesën e diskriminimit është më i ulët për rastet e diskriminimit në bazë të përkatësisë politike (3,5%), përkatësisë etnike (4,4%) dhe orientimit seksual (6,2%), vijuar nga bazat: fe ose bindje dhe hendikep (të dyjat me 7,3%), përderisa për kategoritë tjera perceptimi i tillë shfaqet deri 14,5% për bazën moshë dhe 16,4% të larta për bazën gjini. Në këtë kuptim, rezultatet tregojnë një gjendje të ngjashme, në krahasim me hulumtimet e zbatuara në vitet 2009 dhe 2013. Është kjo gjë falë faktit se shoqëria ka ndërtuar perceptimin se jobarazia historike e këtyre dy grupeve nuk vështrohet si manifestim i diskriminimit dhe prandaj as individët nuk perceptojnë atë si të tillë. Për shembull, organet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, e sidomos Komiteti për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit të Grave dhe Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor në kuadër të Kombeve të Bashkuara tregojnë për pozitën tradicionale të gruas në familje në shoqërinë tonë, gjë kjo e cila rezulton me, inter alia, analfabetizëm më të madh, braktisje të shkollës nga vajzat, e sidomos vajzat nga komuniteti etnik rom, shkallë më të lartë të varfërisë, rrezik të rritur nga dhuna në familje dhe përfaqësim të pamjaftueshëm në jetën politike dhe ekonomike. Megjithatë, nëpërmjet të analizës së të dhënave po bëhet shumë e qartë se është kjo një fushë ku mungon perceptimi real i diskriminimit dhe të kuptuarit e përfshirjes së tij. I njëjti arsyetim nëpërmjet të mbizotërimit të sistemit tradicional të vlerave po shfrytëzohet për të sqaruar nivelin e ulët të vetëdijes për diskriminimin në baza tjera, e sidomos në bazë të moshës dhe hendikepit.


Në gjithë tre hulumtimet (2009, 2013 dhe 2015), perceptimi për ekzistimin e diskriminimit në bazë të përkatësisë politike është më i përhapuri, i cili pastaj vijohet nga baza përkatësi etnike. Domethënë, 53,9% nga të anketuarit kanë deklaruar se diskriminimi në bazë të përkatësisë politike është një dukuri e shpeshtë, ndërsa 50,8% se diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike është një dukuri e shpeshtë, pastaj vijon shpeshtimi i diskriminimit në bazë të orientimit seksual (44,6%), në bazë të fesë dhe bindjes (40,7%), në bazë të hendikepit (35,4%), në bazë të gjinisë (27,5%) dhe në bazë të moshës (18,9%). Ajo që mund të vërehet për këtë hulumtim është se është një numër konsiderueshëm i lartë të përgjigjeve “nuk e di”, e cila graviton mes 9,4% për bazën gjini deri në 17% për bazën orientim seksual. Gjithashtu, po vërehet rënie e nivelit të perceptimit tek të anketuarit për shpeshtimin e diskriminimit në të gjitha bazat nga viti 2009 e këndej, përveç tek orientimi seksual dhe tek feja ose bindja, ku vërehet një rritje e pakonsiderueshme. Një rënie e konsiderueshme paraqitet tek baza moshë me 29,6%, tek përkatësia politike me 23,9%, tek baza gjini me 12,3% dhe tek hendikepi me rënie nga 9,4% (Tabela 14).

Tabela 14

Baza	2015	2013	2009
Përkatësia etnike	50,8 %	51 %	54,6 %
Gjinia	27,5 %	36,6 %	39,8 %
Orientimi seksual	44,6 %	46,3 %	39,9 %
Mosha	18,9 %	39,8 %	48,5 %
Feja ose bindja	40,7 %	40,7 %	36,9 %
Hendikepi	35,4 %	42,1 %	44,8 %
Përkatësia politike	53,9 %	78,3 %	77,8 %

Duke i kryqëzuar rezultatet sipas veçorive socio-demografike (Grafiku 24), mund të vërehet në hulumtimin e fundit të vitit 2015 - një dukuri e shpeshtë e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike mbi vlerën mesatare, me 50,8% vërejnë maqedonasit (53,2%), vllahët (60%) dhe më së shumti romët me 66,7% të larta, për dallim nga shqiptarët (46,2%) dhe turqët (28,6%). Kjo gjë është një risi, nëse krahasojmë me rezultatet nga dy hulumtimet e mëhershme, ku dukurinë e shpeshtë të diskriminimit sipas përkatësisë etnike e vërejnë shqiptarët më tepër se maqedonasit (për shembull: 80% përkundër 43% në vitin 2009).

Grafiku 24




Dallime të dukshme në mesin e veçorive sociodemografike të të anketuarve, të cilët janë deklaruar se një formë e caktuar e diskriminimit po shfaqet vazhdimisht, janë identifikuar vetëm disa forma të diskriminimit. Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike perceptohet si një dukuri e shpeshtë tek: më tepër tek romët dhe vllahët, sesa tek komunitetet tjera; shumë më tepër tek pjesëtarët e konfesionit të krishter-ortodoks (52,9%), sesa tek pjesëtarët e konfesionit islam (45,4%), dhe më tepër tek gratë (52,7%), sesa tek burrat (48,6%).

Diskriminimi në bazë të fesë ose bindjes është një dukuri e shpeshtë më tepër tek maqedonasit (44,8%), sesa tek shqiptarët (30,7%) dhe tek shumica e pjesëtarëve të konfesionit ortodoks (44,6%), sesa tek konfisioni musliman (29,1%), siç është prezantuar në Grafikon 25, gjë kjo e cila është një kuriozitet, për dallim nga dy hulumtimet e mëhershme (2009 dhe 2013). Edhe krahas asaj se ekziston një përputhje e madhe midis dy komuniteteve më të numërta etnike (ai maqedon dhe ai shqiptar) dhe dy grupeve më të numërta fetare

(ai ortodoks dhe ai musliman), diskriminimi në bazë etnike dhe në bazë fetare nuk po vështrohet në të njëjtën mënyrë. Më saktësisht, diskriminimi në bazë të fesë ose bindjes vështrohet si një formë mesatarisht e përfaqësuar e diskriminimit, për dallim nga diskriminimi etnik i cili është i dyti sipas shpeshtësisë, dhe vijon pas përkatësisë politike. Sa i përket gjinisë, burrat (42,4%) konsiderojnë se diskriminimi në bazë të fesë dhe bindjes është më i shpeshtë, sesa gratë (39,6%).


Grafiku 25




Diskriminimi në bazë të përkatësisë gjinore është dukuri e shpeshtë tek: më tepër tek maqedonasit (28,4%), sesa tek shqiptarët (25%), por dallimi është i papërfillshëm, më tepër tek pjesëtarët e konfesionit ortodoks (28,5%), sesa tek pjesëtarët e konfesionit musliman (25,6%), si dhe tek shumica e grave (33,7%), sesa tek burrat (18,9%), ku dallimi është i konsiderueshëm.

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual është perceptuar si një dukuri e shpeshtë tek: një numri më të madh të maqedonasve (56,3%), sesa të shqiptarëve (17,9%), tek shumica e pjesëtarëve të konfesionit ortodoks (56,8%), sesa tek ai musliman (19,8%), tek shumica e grave (47,5%), sesa tek burrat (40,3%), tek shumica e të anketuarve që banojnë në qytet (54,4%), sesa të atyre që banojnë në fshat (28,8%), gjë kjo e cila paraqet një dallim të konsiderueshëm, ashtu siç është prezantuar në Grafiket 26, 27 dhe 28. Megjithatë, më sa duket, përfitimi i debatit rreth diskriminimit është ngritja e vetëdijes rreth kësaj praktike të njerëzve me orientim joheteroseksual. Ashtu siç është krahasuar me hulumtimet (2009 dhe 2013), perceptimi se diskriminimi në këtë bazë ekziston – ai është rritur. Megjithatë, rezultatet tjera tregojnë se nuk është arritur një ndjeshmëri më e madhe lidhur me këtë problem, por vetëm se ekziston një vetëdije më e lartë për ekzistimin e tij në praktikë. Në këtë kuptim, nevojitet një punë goxha më e madhe në këtë fushë nga institucionet kompetente, në bashkëpunim me organizatat e interesuara qytetare.


Grafiku 26



Grafiku 27



Grafiku 28



Hulumtimi zbuloi se diskriminimin në bazë të hendikepit më së shpeshti e vërejnë gratë dhe pjesëtarët e komunitetit etnik maqedonas dhe të krishterët ortodoks. Gjegjesisht, për këtë formë të diskriminimit mendojnë se është një dukuri e shpeshtë: shumica e të anketuarve maqedonas (40,3%), sesa shqiptarë (25,6%), pjesëtarët e konfesionit ortodoks (38,7%), sesa ata të konfesionit musliman (25,6%), dhe shumica e grave të anketuara (40,6%), sesa burrat (28,3%), dhe dallimi është i konsiderueshëm tek gjithë tre kategoritë.

Për dallim nga perceptimi për diskriminimin në bazë të hendikepit, bazën e përkatësisë politike vërejnë si dukuri të shpeshtë të gjitha grupet e të anketuarve barazisht, pa lëvizje më të mëdha varësisht nga veçoritë socio-demografike të tyre. Nga ana tjetër, niveli i ulët i shpeshtimit të diskriminimit në bazë të moshës po vërehet, përsëri, tek të gjitha grupet e të anketuarve barazisht, pa lëvizje të mëdha nga pikëpamja e origjinës etnike, fesë ose gjinisë.


Se sa shpesh do të perceptohet një formë e caktuar e diskriminimit varet edhe nga ajo nëse në rrethin shoqëror të të anketuarve dhe pjesëtarëve të grupeve të ndryshme të cilat mund t'i nënshtrohen diskriminimit dhe nëse të anketuarit veten definojnë si pjesëtarë të grupeve pakicë.

3.1.2. Lufta kundër diskriminimit

Investimi në çrrënjosjen e diskriminimit është shumë pak i dukshëm për të anketuarit. **Kjo njohuri arrihet nëpërmjet të një analize të të anketuarve lidhur me pyetjen A do të kishit mund të thoni se në vend po bëhen përpjekje për luftë kundër të gjitha formave të diskriminimit?** Gjegjesisht, gjysma e të anketuarve (47,2%) nuk shohin se ekzistojnë përpjekjet, respektivisht, ato i konsiderojnë të jenë të pamjaftueshme, ndërsa 23,1% konsiderojnë se pjesërisht ose plotësisht po bëhen përpjekje nga shteti. Edhe këtu ekziston një përqindje e lartë e përgjigjeve “nuk e di” (18,9%), gjë kjo e cila dëshmon për ekzistimin e nivelit të ulët të vetëdijes në mesin e popullatës së re lidhur me masat që po ndërmerren shteti në lëmin e kundër-diskriminimit (Grafiku 29). Kjo gjë është e lidhur me perceptimin e ekzistimit të diskriminimit. Ata që konsiderojnë se ai po ekziston, nuk shohin përpjekje që ai të çrrënjohet.

Grafiku 29

Marrë në përgjithësi, a do të kishit mund të thoni se në vend po bëhen përpjekje për luftimin e të gjitha formave të diskriminimit?



Nuk ekziston një dallim i konsiderueshëm mes perceptimeve të komuniteteve të ndryshme etnike në lidhje me këtë pyetje, e as dallime të konsiderueshme në bazë të gjinisë ose fesë. Megjithatë, vlerësimet e masave që po ndërmerren në luftën kundër diskriminimit janë në masë të madhe të lidhura me perceptimet e të anketuarve në lidhje me shpeshtimin e formave të ndryshme të diskriminimit, dhe kështu shumica e atyre që mendojnë se diskriminimi është një dukuri e shpeshtë në vend pretendojnë se nuk po merren masa të mjaftueshme në luftën kundër tij.

Në të gjitha hulumtimet (2009, 2013 dhe 2015), perceptimi për masat e ndërmarra nga shteti për luftën kundër diskriminimit është se ato janë të pamjaftueshme. Gjegjesisht, kjo përqindje lëkundet, nga 48,8% në vitin

2009, përmes 59,4% në vitin 2013 e deri në 47,2% në vitin 2015. Në shkallë të konsiderueshme bie përqindja e të anketuarve që konsiderojnë se, nëse llogaritet në mënyrë kumulative, plotësisht ose mjaftueshëm po bëhen përpjekje për luftimin e diskriminimit, duke u nisur nga 45,8% të larta (2009), përmes 34,2% (2013) e deri në 23,1% në vitin 2015 (Tabela 15).

Tabela 15

	2015	2013	2009
Nuk po bëhen përpjekje fare	15,2 %	14,0 %	20,6 %
Pamjaftueshëm po bëhen përpjekje	32,0 %	45,4 %	28,2 %
Mjaftueshëm po bëhen përpjekje	17,1 %	27,8 %	34,4 %
Plotësisht po bëhen përpjekje	6,0 %	6,4 %	11,4 %

3.2. Gjuha e urrejtjes

Gjuha e urrejtjes po shkakton një dëm të madh, si për individët konkret të cilëve u përket shprehja, ashtu dhe për shoqërinë në tërësi. Ajo shkel idealin e barazisë ose trajtimit të barabartë dhe parimit të mosdiskriminimit, që janë fundamentale për çdo shoqëri demokratike. Gjuha e urrejtjes ka ndikim të dëmshëm për rendin shoqëror, paqen shoqërore dhe cilësinë e jetesës së komunitetit – kjo gjuhë ka kapacitetin që në mënyrë serioze ta dëmtojë pëlhurën shoqërore dhe t'i përçajë komunitetet. Dhe në fund, gjuha e urrejtjes potencialisht çon drejt krimit nga urrejtja (Mihajlllova, Baçovska, Sheqerxhiev, 2013).

Kjo pjesë e hulumtimit kishte për qëllim ekzaminimin e perceptimit të qytetarëve në moshë nga 16 deri 24 vjeç, për dy temat në vijim: e para, perceptimi i përfaqësimit të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, gjinisë, orientimit seksual, moshës, fesë ose bindjes, hendikepit dhe përkatësisë politike, dhe e dyta, përvojat me gjuhën e urrejtjes së të anketuarve në drejtim të gjuhës së përjetuar të urrejtjes. Të dhënat po shqyrtohen dhe po komentohen së bashku me pyetjet lidhur me qëndrimet që kanë të bëjnë me pranimin e dallimeve nga pjesa e parë e hulumtimit, të sqaruara më herët, gjegjësisht, vendosja e vetes në rrethin e diversitetit social dhe vetëperceptimit të përkasjes një grupi të caktuar.

3.2.1 Perceptimi për gjuhën e urrejtjes

Në pyetjen **Sa e shpeshtë është secila nga format e numëruara të gjuhës së urrejtjes?**, të anketuarit duhej të përcaktinin nivelin e ekzistimit të gjuhës së urrejtjes në shoqërinë, të motivuar nga përkatësia etnike, gjinia, orientimi seksual, moshë, feja ose bindja, hendikepi (mendor dhe trupor) dhe nga përkatësia politike. Me këtë, u ofruan disa përgjigje alternative (nuk ekziston, është shumë e rrallë, është mjaft e rrallë, është mjaft e shpeshtë dhe është shumë e shpeshtë), të cilat pasqyrojnë shkallën nga 1 deri 5, ku 1 është niveli më i ulët i ekzistimit të gjuhës së urrejtjes në bazën përkatëse, kurse 5 është shkalla më e lartë e ekzistimit të gjuhës së urrejtjes. Në Tabelë po prodhohet indeksi që është rezultat i mesit aritmetik nga përgjigjet e fituara, ku indeksi më i lartë përcakton pajtimin më të lartë me ekzistimin e gjuhës së urrejtjes, të motivuar nga baza përkatëse. Gjatë procesimit të të dhënave në bazë të përkatësisë etnike dhe fetare, janë analizuar vetëm të dhënat mbi dy komunitetet më të mëdha etnike dhe fetare në vend.

Sipas rezultateve të hulumtimit, perceptimi për ekzistimin e gjuhës së urrejtjes është akoma gjerësisht **më i përhapur se perceptimi për mungesën e saj** (Tabela 16). Edhe këtu, njëjtë si dhe tek përgjigjet për shpeshimin e diskriminimit, të anketuarit konsiderojnë se gjuha e urrejtjes është më e shpeshtë në bazë të përkatësisë politike dhe përkatësisë etnike, dhe pastaj vijon orientimi seksual, feja ose bindja, dhe hendikepi. Nivelin më të ulët të ekzistimit të gjuhës së urrejtjes, të anketuarit gjejnë tek baza gjini dhe moshë.

Tabela 16

Gjuha e urrejtjes							
Baza	Gjithsej	Gjinia		Përkatësia etnike		Përkatësia etnike	
		Mashkullore	Femërore	Maqedone	Shqiptare	Ortodokse	Islame
Përkatësia etnike	3,59	3,70	3,48	3,55	3,70	3,53	3,63
Gjinia	2,71	2,67	2,75	2,72	2,71	2,73	2,65
Orientimi seksual	3,61	3,60	3,59	3,89	2,51	3,87	2,68
Mosha	2,52	2,57	2,47	2,48	2,64	2,45	2,69
Feja ose bindja	3,39	3,42	3,36	3,39	3,31	3,38	3,31
Hendikepi	3,08	2,86	3,30	3,17	2,74	3,19	2,71
Përkatësia etnike	3,98	3,78	4,18	4,02	3,88	3,98	3,83

Perceptimi për mungesën e gjuhës së urrejtjes është më i ulët tek rastet në bazë të përkatësisë politike (3,7%), përkatësisë etnike (5%) dhe fesë ose bindjes (5,6%), pastaj vijojnë bazat orientimi seksual (7,3%) dhe hendikepi (8,9%), kurse për kategoritë tjera, perceptimi i tillë shfaqet deri në 15,4% të larta për bazën gjini dhe 16,8% për bazën moshë. Në këtë kuptim, rezultatet tregojnë një gjendje të ngjashme në krahasim me gjetjet e hulumtimit të perceptimit për format e ndryshme të diskriminimit. Domethënë, perceptimi i rritur për ekzistimin e gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë politike lidhet me faktin se është rritur politizimi i shoqërisë në përgjithësi. Nga ana tjetër, edhe pse ekziston një gjuhë e evidente e përditshme mizogjenike në diskursin publik, ajo në mënyrë latente po arsyetohet, dhe prandaj as të anketuarit nuk po e perceptojnë atë si të gabueshëm dhe për ta gjykuar. Megjithatë, nëpërmjet të analizës së të dhënave po bëhet gjithnjë e më e qartë se është ky një lëmë në të cilin mungon perceptimi real për ekzistimin e gjuhës së urrejtjes dhe formave dhe elementeve të saja. Argumentimi i njëjtë nëpërmjet të dominimit të sistemit tradicional të vlerave përdoret edhe për sqarimin e nivelit të ulët të vetëdijes për diskriminimin në baza tjera, e sidomos në bazë të moshës dhe hendikepit, e cila akoma në shoqëri po vështrohet nga aspekti i modelit mjekësor, dhe jo nga aspekti i të drejtave të njeriut.

Veç kësaj, 47,4% të të anketuarve kanë thënë se gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë politike paraqet një dukuri të shpeshtë, kurse 42,5% se baza është përkatësia etnike, e vijuar nga shpeshtimi i gjuhës së urrejtjes në bazë të orientimit seksual (40,4%), fesë ose bindjes (36,8%), hendikepit (26,8%), gjinisë (21,6%) dhe moshës (15,2%). Ajo që mund të vërehet në këtë hulumtim është se ekziston një numër konsiderueshëm i lartë i përgjigjeve “nuk e di”, i cili graviton midis 11,2% për bazën përkatësi etnike dhe fe ose bindje, e deri në 18,1% për bazën hendikep (Tabela 17).

Tabela 17


Baza	Gjuha e shpeshtë e urrejtjes
Përkatësia etnike	42,5 %
Gjinia	21,6 %
Orientimi seksual	40,4 %
Mosha	15,2 %
Feja ose bindja	36,8 %
Hendikepi	26,8 %
Përkatësia etnike	47,4 %

Me kryqëzimin e rezultateve sipas veçorive socio-demografike, mund të vërehet se një formë të shpeshtë të gjuhës së urrejtjes për arsye të përkatësisë etnike mbi vlerën mesatare nga 42,5% vërejnë maqedonasit me një rritje të papërfillshme të përqindjes, e cila arrin 44,4%, si dhe vlllehët (60%) dhe më së shumti romët me 66,6% të larta, për dallim nga shqiptarët (38,5%). Të anketuarit turq konsiderojnë se gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike është një dukuri shumë e rrallë. Me përjashtim të të dhënave mbi komunitetin etnik maqedon dhe atë shqiptar, të tjerët duhet të shërbejnë vetëm për ilustrim dhe duhet të merren me rezerva, pasi që numri absolut i të anketuarve nga komunitetet e tjera etnike është tepër i ulët për të nxjerrë konkluzione të përgjithshme relevante.

Dallime të dukshme midis veçorive socio-demografike të të anketuarve që janë deklaruar se gjuha e urrejtjes mbi një veçori të caktuar të mbrojtur po shfaqet shpesh, janë gjetur vetëm për disa forma shfaqëse të gjuhës së urrejtjes. Gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike perceptohet si një dukuri e shpeshtë tek: më tepër tek romët dhe vlllehët, sesa tek komunitetet tjera, larg më tepër tek pjesëtarët e konfesionit të krishter-ortodoks (33,1%), sesa tek pjesëtarët e konfesionit islam (44%), dhe papërfillshëm më shumë tek burrat (42,9%), sesa tek gratë (42,6%).

Gjuha e urrejtjes në bazë të fesë ose bindjes është një dukuri e shpeshtë tek: më tepër tek maqedonasit (39,8%), sesa tek shqiptarët (28,2%), siç është prezantuar në Grafikun 30 dhe tek shumica e pjesëtarëve të konfesionit ortodoks (39,9%), sesa tek pjesëtarët e atij musliman (27,9%). Njëjtë si tek diskriminimi në këtë bazë, edhe gjuha e urrejtjes në bazë të fesë ose bindjes po perceptohet si një formë mesatarisht e përfaqësuar e gjuhës së urrejtjes, për dallim nga diskriminimi etnik, i cili është i dyti sipas shpeshtësisë dhe vijon pas përkatësisë politike.


Grafiku 30




Gjuha e urrejtjes në bazë të gjinisë po vërehet si një dukuri e shpeshtë tek: më shumë tek maqedonasit (24,8%), sesa tek shqiptarët (15,4%), me shumë tek pjesëtarët e komunitetit ortodoks (25,7%), sesa tek ai musliman (13,9%), si dhe më shumë tek gratë (23,6%), sesa tek burrat (18,8%), edhe pse ky dallim është i vogël.

Gjuha homofobike është perceptuar si një dukuri e shpeshtë tek: numri jashtëzakonisht më i lartë i maqedonasve (53,4%), sesa tek shqiptarët (11,6%), siç është prezantuar në Grafikun 31, më shumë tek konfisioni ortodoks (52,7%), sesa tek ai musliman (13,3%), më shumë tek të anketuarit që banojnë në qytet (49,6%), sesa tek ata që banojnë në fshat (25,3%), siç është prezantuar në Grafikun 32, me dallime të stërmëdha midis gjithë tre kategorive, dhe pothuajse me një numër identik të grave (41,3%) dhe burrave (38,7%). Brengos fakti se ekziston një dallim i stërmadh në perceptimin e gjuhës homofobike midis komunitetit etnik maqedon dhe atë shqiptar, gjë kjo e cila pasqyrohet në ekzistimin e dallimit të stërmadh dhe midis dy konfesionëve më të mëdha në shoqëri, kur bëhet fjalë për këtë çështje. Kjo do të kishte mund të interpretoheshte me shkallën më të lartë të religjiozitetit tek komuniteti etnik shqiptar, si dhe arsyetimi i përdorimit të gjuhës homofobike të kthyer drejt komunitetit LGBTI.

Grafiku 31




Grafiku 32



Gjuha e urrejtjes në bazë të hendikepit, njëjtë si dhe tek diskriminimi në këtë bazë, është perceptuar si një dukuri e shpeshtë nga: shumica e të anketuarve maqedonas (31,6%), sesa shqiptarë (16,6%) dhe dallimi është i konsiderueshëm tek pjesëtarët e konfesionit të krishter-ortodoks (31,6%), sesa tek ata të konfesionit islam (18,3%), dhe më tepër tek gratë e anketuara (31,8%), sesa tek burrat (19,8%) (Grafiku 33).


Grafiku 33



Gjuha e urrejtjes në bazë të moshës po karakterizohet me nivelin e ulët të shpeshtimit, dhe vërehet tek të gjitha grupet e të anketuarve barazisht, pa lëvizje të mëdha në bazë të veçorive socio-demografike të tyre.

Gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë politike po vërehet si një dukuri e shpeshtë tek të gjitha grupet e të anketuarve me lëvizje më të mëdha, në varësi nga origjina etnike dhe gjinia, dhe kjo gjë po vërehet më tepër tek maqedonasit (55,3%), sesa tek shqiptarët (32,7%), siç është prezantuar në Grafikon 34, dhe më tepër tek gratë (52,2%), sesa tek burrat (40,5%).

Grafiku 34




Në mënyrë identike si dhe tek perceptimi i ekzistimit të diskriminimit, se sa shpesh do të perceptohet një formë e caktuar e gjuhës së urrejtjes, varet nga ajo nëse në rrethin shoqëror të të anketuarve janë përfaqësuar dhe pjesëtarë të grupeve të ndryshme që mund t'i nënshtrohen gjuhës së tillë dhe nëse të anketuarit definojnë veten si pjesëtarë të një grupi pakicë, i cili mund të shfaqet si lëndë e gjuhës së urrejtjes.

3.2.2. Përvojat me gjuhën e urrejtjes


Analiza e rezultateve të fituara nga pyetja A keni qenë ndonjëherë lëndë e gjuhës së urrejtjes?, zbulon se 39,3% të të anketuarve nuk janë ndier drejtpërsëdrejti si viktimë të gjuhës së urrejtjes, ndërsa vetëm 21,6% kanë ndier gjuhën e urrejtjes të drejtuar ndaj tyre për arsye të ndonjë veçorie të mbrojtur konkrete. Të anketuarit po shfaqin një tendencë që të mos identifikojnë një sjellje të tillë, nëse u është drejtuar atyre. Një përqindje e lartë bie nën përgjigjen “nuk e di” (31,2%), gjë kjo e cila tregon për nivelin e ulët të vetëdijes tek të anketuarit lidhur me atë se çka paraqet gjuha e urrejtjes dhe cilat janë simbolet e saja (Grafiku 35).

Grafiku 35



Në mesin e atyre që personalisht kanë përjetuar gjuhën e urrejtjes, 27,4% janë burra, dhe 17,4% janë gra. Nga maqedonasit, 23,7% janë deklaruar se kanë ndier gjuhën e urrejtjes për ndonjë veçori të veten, kurse kjo përqindje tek shqiptarët arrin 14,7%. Gjysma e të anketuarve shqiptarë konsiderojnë se nuk kanë qenë lëndë e gjuhës së urrejtjes, përderisa kjo përqindje tek të anketuarit maqedonas është një e treta (Grafiku 36). Gjuhën e urrejtjes më shpesh e ndiejnë të anketuarit me konfesion katolik (50%) dhe me konfesion ortodoks (23,5%), si dhe ateistët (38,5%), për dallim nga të anketuarit me konfesion musliman, ku përqindja është 15,1%. 24,2% të të anketuarve që banojnë në qytet kanë ndier gjuhën e urrejtjes drejtpërsëdrejti, dhe kjo përqindje për ata që banojnë në fshat arrin 18,4%.

Grafiku 36



3.3. Krimi nga urrejtja

Krimi i motivuar nga jotoleranca ndaj grupeve të caktuara në shoqëri po përshkruhet si krim nga urrejtja. Krimin nga urrejtja e përbëjnë dy elemente: i pari, vepra patjetër duhet qenë e kualifikuar si vepër penale me Kodin Penal, dhe e dyta, motivi për kryerjen e veprës patjetër duhet të bazohet mbi një paragjykimi të caktuar. “Motivi i bazuar mbi paragjykime” do të thotë se kryerësi përzgjedh objektivin e veprës së denueshme në bazë të një veçorie të mbrojtur. Objektivi mund të jetë një person, disa persona ose një pronë, që lidhen me një grup të caktuar, pjesëtarët e të cilit po ndajnë ndonjë veçori të mbrojtur të caktuar. Një veçori e mbrojtur paraqet një veçori elementare ose thelbësore, e cila cilëson grupin, si për shembull, “raca”, konfesionin, përkatësia etnike, gjuha, hendikepi, ose orientimi seksual. Dukuritë individuale të krimit nga urrejtja me vete mbajnë zanafillën e konflikteve të mundshme, pasi që mund të eskalojnë si për nga numri i personave të prekur, ashtu dhe për nga intensiteti i dhunës. Rrethi i dhunës mund të ndërpritet nëse kjo gjë pranohet dhe nëse ndërmerren masa të vendosura (OSBE/ODIHR, Misioni i OSBE-së në Shkup, 2014).

Kjo pjesë e hulumtimit kishte për qëllim ekzaminimin e perceptimit të qytetarëve në moshë nga 16 deri 24 vjeç për dy temat në vijim: e para, perceptimi për prezencën e krimit nga urrejtja në bazë të përkatësisë etnike, gjinisë, orientimit seksual, moshës, fesë ose bindjes, hendikepit dhe përkatësisë politike dhe e dyta, përvojat me krimin nga urrejtja të të anketuarve për sa i përket krimit të përjetuar nga urrejtja ose informacionit për një krim të kryer nga urrejtja në përgjithësi, për të cilin i anketuari ka njohuri. Të dhënat po shqyrtohen dhe po komentohen, së bashku me pyetjet për qëndrimet e prezantuara në lidhje me pranimin e dallimeve nga pjesa e parë e hulumtimeve që u shtjellua më herët, gjegjësisht, vendosja e vetes në rrethin e diversitetit shoqëror dhe vetë-perceptimit të përka sjes ndonjë grupi të caktuar.

3.3.1. Perceptimi për krimin nga urrejtja

Në pyetjen **Sa është e shpeshtë secila nga format e numëruara të krimit nga urrejtja?**, të anketuarit duheshite të përcaktonjin nivelin e ekzistimit të krimit nga urrejtja në shoqëri, të motivuar nga përkatësia etnike, gjinia, orientimi seksual, mosha, feja ose bindja, hendikepi (hendikepi mendor dhe trupor) dhe përkatësia politike. Me këtë u ofruan disa përgjigje alternative (nuk ekziston, është shumë i rrallë, është mjaftë i rrallë, është mjaftë i shpeshtë dhe është shumë i shpeshtë), të cilat pasqyrojnë shkallën nga 1 deri 5, ku 1 është niveli më i ulët i ekzistimit të krimit nga urrejtja mbi bazën përkatëse, dhe 5 është niveli më i lartë i ekzistimit të krimit nga urrejtja. Në Tabelë po prodhohet një indeks, i cili është rezultat i mesit aritmetik të përgjigjeve të grumbulluara, ku indeksi më i lartë shënon pajtimin më të madh me ekzistimin e krimit nga urrejtja të motivuar nga baza përkatëse. Gjatë procesimit të të dhënave në bazë të përkatësisë etnike dhe fetare, janë analizuar vetëm të dhënat mbi dy komunitetet më të mëdha etnike dhe fetare në vend.

Sipas rezultateve të hulumtimit, perceptimi për ekzistimin e krimit nga urrejtja është akoma gjerësisht më i përhapur se perceptimi se ai po mungon (Tabela 18). Edhe këtu, në mënyrë identike si tek përgjigjet për shpeshimin e diskriminimit dhe shpeshimin e gjuhës së urrejtjes, të anketuarit konsiderojnë se krimi nga urrejtja është më i shpeshtë në bazë të përkatësisë politike dhe përkatësisë etnike. Për dallim nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes, baza e tretë e shpeshimit të krimit nga urrejtja është feja ose bindja, vijuar nga orientimi seksual, si baza e katërt. Nivelin më të ulët të ekzistimit të krimit nga urrejtja të anketuarit e vërejnë tek baza hendikep, gjini dhe moshë. Hendikepi, tek diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes po lëviz nga “mjaftë i rrallë” në “mjaftë i shpeshtë”, përderisa tek krimi nga urrejtja po lëviz nga “mjaftë i rrallë” në “shumë i rrallë”.

Tabela 18

Krimi nga urrejtja							
Baza	Gjithsej	Gjinia		Përkatësia etnike		Përkatësia fetare	
		Mashkullore	Femërore	Maqedone	Shqiptare	Ortodokse	Islame
Përkatësia etnike	3,48	3,44	3,52	3,42	3,64	3,40	3,58
Gjinia	2,52	2,47	2,57	2,51	2,53	2,49	2,54
Orientimi seksual	3,25	3,19	3,31	3,41	2,63	3,42	2,72
Mosha	2,47	2,49	2,45	2,48	2,43	2,44	2,41
Feja ose bindja	3,26	3,41	3,11	3,29	3,21	3,23	3,17
Hendikepi	2,83	2,84	2,82	2,88	2,65	2,88	2,65
Përkatësia etnike	3,91	3,84	3,98	4,03	3,58	4,02	3,57

Perceptimi për mungesën e krimit nga urrejtja është më i ulët për rastet në bazë të përkatësisë politike (4,2%), përkatësisë etnike (6,2%) dhe fesë ose bindjes (6,7%), vijuar nga bazat orientim seksual (7,7%) dhe hendikep (11,8%), përderisa për kategoritë tjera, perceptimi i tillë po shfaqet deri në 16,8% të larta për bazën gjini dhe 18,1% për bazën moshë. Në këtë kuptim, rezultatet tregojnë një gjendje të ngjashme në krahasim me gjetjet hulumtuese lidhur me perceptimin për format e ndryshme të diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes. Arsyetimi i njëjtë për këto dy dukuri po përdoret dhe për interpretimin e gjetjeve mbi ekzistimin e krimit nga urrejtja, gjegjësisht, politizimi i rritur i përditshmërisë çon drejt perceptimit për ekzistimin e përkatësisë politike, edhe pse kjo gjë bashkëvepron plotësisht me realitetin. Nga ana tjetër, po mbijeton niveli i ulët i vetëdijes për krimin nga urrejtja, sidomos të personave me hendikep dhe të qytetarëve më të moshuar. Sipas të dhënave nga monitorimi i rasteve të krimit nga urrejtja dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja, të cilat mund të ndjeken në ueb faqen www.zlostorstvaodomraza.com, po zbulon se në periudhën 2013-2016, baza më e shpeshtë është përkatësia etnike, me një përqindje jashtëzakonisht të lartë të gjithë rasteve të regjistruara të krimit nga urrejtja (64%), vijuar nga bazat tjera, siç është përkatësia politike (12%), statusi i refugjatit ose migrantit (9%), feja ose bindja (7%) dhe orientimi seksual ose identiteti gjinor (6%). Vetëm një rast është regjistruar i krimit nga urrejtja i motivuar nga njëanshmëria në bazë të hendikepit (0,4%). Pjesa më e madhe e veprave penale të regjistruara si krim nga urrejtja përfshijnë: dhunë, vjedhje, duke përfshirë këtu dhe vjedhjen e armatosur, lëndimin trupor, duke përfshirë këtu dhe lëndimet e rënda trupore, dëmin pronësor dhe pjesëmarrjen në përlëshje (Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, 2016).

Hulumtimi zbuloi se 42,2% nga të anketuarit kanë thënë se krimi nga urrejtja në bazë të përkatësisë politike është një dukuri e shpeshtë, ndërsa 33,9% janë deklaruar në mënyrë identike për bazën përkatësi etnike, vijuar nga shpeshtimi i krimit nga urrejtja në bazë të fesë ose bindjes (28,7%), të orientimit seksual (28,5%), të hendikepit (18,6%), të gjinisë (15%) dhe të moshës (13,9%). Ajo që mund të vërehet për këtë hulumtim është se ka një numër të madh të përgjigjeve “nuk e di”, i cili graviton midis 21,2% për bazën gjini e deri në 26,2% për bazën hendikep (Tabela 19).

Tabela 19

Baza	Krimi i shpeshtë nga urrejtja
Përkatësia etnike	33,9 %
Gjinia	15,0%
Orientimi seksual	28,5 %
Mosha	13,9 %
Feja ose bindja	28,7 %
Hendikepi	18,6 %
Përkatësia politike	42,2 %

Në mënyrë të krahasuar po vërehet tendenca e reduktimit të përqindjes së shpeshimit në të gjitha bazat, me përqindjen më të lartë tek perceptimi për ekzistimin e diskriminimit, pastaj tek ekzistimi i gjuhës së urrejtjes, dhe në fund tek shpeshimi i krimit nga urrejtja. Është kjo gjë e logjikshme, pasi që diskriminimi si dukuri është shumë më i gjerë, për dallim nga gjuha e urrejtjes, e sidomos nga krimi i urrejtjes, edhe pse që të tre dukuritë po shfaqen paralelisht për arsye të ekzistimit të paragjykimeve negative dhe stereotipeve ndaj grupeve të ndryshme të njerëzve në shoqërinë maqedonase.


Me kryqëzimin e rezultateve sipas veçorive socio-demografike, mund të vërehet se perceptimi për krimin nga urrejtja për arsye të përkatësisë etnike, si një dukuri e shpeshtë po numërohet në një përqindje përafërsisht të njëjtë tek gjithë të anketuarit nga grupet e ndryshme etnike, si vijon: tek vllahët arrin 40%, tek shqiptarët 34,6%, tek maqedonasit 34%, si dhe tek romët 33,4%, për dallim nga turqët (14,3%). Me përjashtim të të dhënave mbi komunitetin etnik maqedonas dhe atë shqiptarë, të tjerët duhet të shërbejnë vetëm sa për ilustrim, ngaqë numri absolut i të anketuarve nga komunitetet tjera etnike është tepër i ulët për të nxjerrë konkluzione të përgjithshme relevante.

Dallime të dukshme midis veçorive socio-demografike të të anketuarve që janë deklaruar se krimi nga urrejtja mbi një veçori të caktuar të mbrojtur po shfaqet shpesh, janë gjetur vetëm për disa manifestime të krimit nga urrejtja.

Ashtu siç u elaborua më lartë, krimi nga urrejtja në bazë të përkatësisë etnike po perceptohet si një dukuri e shpeshtë tek të gjithë komunitetet etnike barazisht, por larg më shumë tek pjesëtarët e konfesionit ortodoks (34,2%), sesa tek ata të konfesionit islam (22%) dhe më shumë tek burrat (34,4%), sesa tek gratë (33,9%), por dallimi është i papërfillshëm.

Krimi nga urrejtja në bazë të fesë ose bindjes është një dukuri e shpeshtë tek: më tepër tek maqedonasit (31,3%), sesa tek shqiptarët (23,7%), siç është prezantuar në Grafikon 37 dhe më tepër tek pjesëtarët e komunitetit ortodoks (30,3%), sesa tek komuniteti musliman (22,7%). Njëjtë si tek diskriminimi, ashtu edhe tek gjuha e urrejtjes në këtë bazë, edhe tek krimi nga urrejtja në bazë të fesë ose bindjes po perceptohet si një formë mesatarisht e përfaqësuar e krimit nga urrejtja, për dallim nga përkatësia etnike, e cila është e dyta sipas shpeshimit, dhe vijon pas përkatësisë politike.

Grafiku 37




Krimi nga urrejtja në bazë të gjinisë po vërehet si një dukuri e shpeshtë tek: më tepër tek maqedonasit (16,3%), sesa tek shqiptarët (12,2%), më tepër tek pjesëtarët e konfesionit ortodoks (15,8%), sesa tek ata të konfesionit musliman (12,2%) dhe më tepër tek gratë (16,7%), sesa tek burrat (12,8%), edhe pse ky dallim është mjaftë i vogël.

Krimi nga urrejtja në bazë të orientimit seksual si dukuri e shpeshtë vërehet tek: një numër jashtëzakonisht më të lartë të maqedonasve (34,8%), sesa të shqiptarëve (14,1%), siç është prezantuar në Grafikon 38. Më tepër pjesëtarë të konfesionit ortodoks (35,6%), sesa të konfesionit musliman (12,7%) konsideruan se krimi

nga urrejtja mbi këtë bazë paraqet një dukuri të shpeshtë, përderisa kjo përqindje tek ateistët po ngjitet deri në 53,9%. Gjithashtu, më tepër tek të anketuarit që banojnë në qytet (33,3%), sesa tek ata që banojnë në fshat (19,9%) dhe më tepër tek gratë (32,5%), sesa tek burrat (22,6%) po paraqitet perceptimi i njëjtë. Shqetëson fakti se ekziston një dallim i stërmadh në perceptimin e kësaj dukurie midis komunitetit etnik maqedonas dhe atij shqiptar, nga 20% të plota, e cila pasqyrohet në ekzistimin e dallimit të stërmadh midis dy konfesioneve më të mëdha në shoqëri, kur bie fjala për këtë pyetje. E njëjta tendencë po vërehet edhe tek perceptimi për ekzistimin ose mosekzistimin e gjuhës homofobike në shoqëri, siç sqaruam më herët.

Grafiku 38




Krimi nga urrejtja në bazë të hendikepit është perceptuar si një dukuri e shpeshtë tek: më tepër tek të anketuarit maqedonas (20,5%), sesa tek shqiptarët (15,4%), më tepër tek pjesëtarët e konfesionit ortodoks (21,1%), sesa tek ata të konfesionit musliman (14,6%), dhe më shumë tek gratë e anketuara (19,7%), sesa tek burrat (17,4%), por dallimi është i papërfillshëm.


Krimi nga urrejtja në bazë të moshës po karakterizohet me një nivel të ulët të shpeshtimit, dhe vërehet tek të gjitha grupet e të anketuarve barazisht, pa lëvizje të mëdha në kuptimin e veçorive socio-demografike të tyre.

Krimi nga urrejtja në bazë të përkatesisë politike po vërehet si dukuri e shpeshtë tek të gjitha grupet e të anketuarve, me lëvizje më të mëdha në kuptimin e origjinës etnike dhe moshës, dhe kjo gjë vërehet më tepër tek maqedonasit (49,1%), sesa tek shqiptarët (29,5%), siç është prezantuar në Grafikon 39, më tepër tek pjesëtarët e konfesionit ortodoks (48%), sesa tek ata të konfesionit musliman (28,5%), dhe më tepër tek gratë (45,6%), sesa tek burrat (37,2%), siç është prezantuar në Grafikon 40.

Grafiku 39



Grafiku 40




Në mënyrë identike si dhe tek perceptimi për ekzistimin e diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes në shoqëri, se sa shpesh do të perceptohet një manifestim i caktuar i krimit nga urrejtja, varet edhe nga ajo nëse në rrethin shoqëror të të anketuarve, janë përfaqësuar dhe pjesëtarë të grupeve të ndryshme që janë të prirur për t’u paraqitur si viktime të mundshme të krimit nga urrejtja dhe nëse të anketuarit veten definojnë si pjesëtarë të një grupi pakicë, i cili mund të paraqitet si lëndë e krimit nga urrejtja.

3.3.2. Përvojat me krimin nga urrejtja


Analiza e të dhënave të fituara nga përgjigja e pyetjes **A keni qenë ndonjëherë lëndë, ose keni njohuri për ndonjë rast të krimit nga urrejtja?**, tregon për atë se 40,5% nga të anketuarit nuk janë ndier drejtpërsdrejti si viktime të krimit nga urrejtja, e as nuk kanë njohuri për ndonjë rast të krimit nga urrejtja, kurse vetëm 17,9% kanë ndier efektet e krimit nga urrejtja që janë kthyer drejt tyre, për shkak të ndonjë veçorie të caktuar të mbrojtur, ose dijnë për ndonjë rast të krimit nga urrejtja. Të anketuarit po shfaqin tendencë të mos njohin krimin nga urrejtja, ngase përqindja që bie nën përgjigjen “nuk e di” dhe “nuk kam njohuri” është mjaftë e lartë (në mënyrë kumulative nga dy kategoritë arrijnë 38,2%), gjë kjo e cila tregon për nivelin e ulët të vetëdijes tek të anketuarit lidhur me atë se çka paraqet kjo dukuri dhe cilat janë manifestimet e tij (Grafiku 41).

Grafiku 41



20,3% të burrave dhe 16,4% të grave kanë përjetuar krim nga urrejtja. Në bazën etnike, perceptimi për përvojën personale me krimin nga urrejtja, është i balancuar. Gjegjësisht, nga maqedonasit e anketuar, 18,4% janë deklaruar se janë shfaqur si viktimë e krimit nga urrejtja për arsye të ndonjë veçorie individuale, përderisa kjo përqindje tek shqiptarët është 17,9%. Pothuajse gjysma e të anketuarve shqiptarë (46,2%) konsiderojnë se nuk kanë qenë lëndë e krimit nga urrejtja, e se as nuk kanë njohuri për ndonjë rast konkret, përderisa kjo përqindje tek të anketuarit maqedonas është më se një e treta dhe arrin 38% (Grafiku 42). Krimin nga urrejtja në një vëllim identik ndiejnë ose kanë dijeni për të, të anketuarit e konfesionit musliman (16,3%) dhe të anketuarit e konfesionit ortodoks, ku përqindja është 16,7%. 21,2% të të anketuarve që banojnë në qytet, drejtpërsëdrejti kanë ndier krimin nga urrejtja, përderisa kjo përqindje për të anketuarit që banojnë në fshat arrin 12,4 %.

Grafiku 42



IV. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

KONKLuzionet

- Në vendin tonë, komunitetet etnike më së miri njohin gjuhën maqedone, gjë kjo e cila edhe përkrah mundësisë që arsimit të përvetësosh gjuhën vetjake amë është një gjë për ta pritur, pasi që është kjo gjuha e komunitetit më të madh etnik dhe është në përdorim zyrtar të shtetit. Për sa i përket njohjes së gjuhëve të komuniteteve që banojnë në vend, komuniteti etnik shqiptar ka njohje më të mëdha të gjuhëve të tjera etnike, si për shembull, gjuhën maqedone (84%), dhe një numër i konsiderueshëm i të anketuarve njohin dhe gjuhën serbe (56,4%) dhe gjuhën turke (35,8%). Komuniteti etnik maqedonas dhe ai serb, përveç njohjes së ndërsjellë të gjuhëve të veta, kanë njohje më të ulët të gjuhëve të tjera që po flasin komunitetet në vend. Më së paku e njohur për grupet tjera etnike është gjuha rome.
- Sa i përket shkallës së religjiozitetit, të anketuarit (studentë dhe nxënës të shkollave të mesme) e cilësojnë vetën të jenë religjioz. Nga rezultatet e hulumtimit mund të vërehet se shkalla e religjiozitetit është më e lartë tek të anketuarit nga komuniteti etnik shqiptar (74,4%) dhe të konfesionit islam (75,6%), por na duhet të theksojmë se dallimi i këtyllë në raport me të anketuarit nga komuniteti etnik maqedonas (60,8%) dhe të konfesionit ortodoks të krishter (64,1%) nuk është shumë i madh. Sipas përkatësisë gjinore, gjinia femërore është më religjioze (70,2%), për dallim nga gjinia mashkullore (59,4%).
- Pjesa më e madhe e të anketuarve banojnë në familje katër-anëtarëshe. Tek komuniteti etnik maqedonas, gjithashtu më të përfaqësuara janë familjet katër-anëtarëshe (45,9%), përderisa tek komuniteti etnik shqiptar më të përfaqësuara janë familjet pesë-anëtarëshe (35,9%).
- Nga hulumtimi mund të konkludohet se pjesa më e madhe e të anketuarve, apo gjegjësisht 2/3, janë përcaktuar për mësuarije të detyrueshme ose fakultative të njërit nga gjuhët e komuniteteve që banojnë në vend, dhe e cila gjuhë nuk ka të bëjë me gjuhën e tyre amë. Është interesant fakti se për komunitetin etnik shqiptar gjuha plotësuese duhet të mësohet në mënyrë të detyrueshme (57,1%), kurse për komunitetin etnik maqedonas, ajo duhet të mësohet në mënyrë fakultative (39,5%).
- Segregimi i shoqërisë mund të konstatohet në vetë faktin se pjesa më e madhe e të anketuarve banojnë në lagje etnikisht homogjene (maqedonasit me 62,9% dhe shqiptarët me 64,1%), gjë kjo e cila pasqyrohet në kuadër të bashkëveprimit shoqëror, ku rrethi më i afërt jashtë familjes, që lidhet me miqtë me të cilët po shoqërizohen, është poashtu etnikisht homogjen, respektivisht, ekziston një bashkëveprim i papërfillshëm me komunitetet tjera etnike.
- Pjesa më e madhe e të anketuarve nuk dëshirojnë të shpërngulen nga lagjeja në të cilën banojnë. Është interesante për ta theksuar se përqindja më e vogël e atyre që dëshirojnë të shpërngulen, këtë gjë do të kishin preferuar ta bënin për arsye se lagjeja nuk ka një infrastrukturë të zhvilluar, sepse lagjeja është e ndotur, ose sepse shpërngulja nevojitet për arsye se lagjeja gjendet larg vendit të tyre të punës. Kjo e fundit tregon për një zhvendosje të perceptimeve, madje edhe tek të anketuarit që banojnë në lagje etnikisht të përziera, ku arsyeja e mundshme e shpërnguljes aspak nuk lidhet me bashkëveprimin ndëretnik ose ndërfaqësor si një arsye për këtë. Gjithashtu, është e dukshme se një përqindje më e ulët e të anketuarve që banojnë në lagje etnikisht heterogjene do të kishin dëshiruar të jetonin në lagje etnikisht homogjene, krahasuar me të anketuarit që tanimë banojnë në lagje etnikisht homogjene.
- Konservatizmi i marrëdhënieve midis grupeve etnike, i lidhur me integrimin ndëretnik është pasqyruar në kuadër të qëndrimeve lidhur me mundësinë e lidhjes së martesës me një pjesëtar të një komuniteti tjetër. Barazisht si tek etnitë e ndryshme (maqedonasit me 53,5% dhe shqiptarët me 82,1%), ashtu dhe tek konfesionet e ndryshme (konfisioni i krishter-ortodoks me 59,8% dhe konfisioni islam me 86,6%), fuqishëm është shprehur preferenca për lidhje të martesës në kuadër të komunitetit vetjak. Ashtu siç po rritet religjioziteti, ashtu po rritet dhe konservatizmi i qëndrimeve.

- Në vendin tonë ekziston një distancë etnike fuqishëm e shprehur nga aspekti i stereotipeve të cilat grupet etnike konstruktojnë njëra për tjetrën. Në marrëdhëniet midis komunitetit etnik maqedon dhe atë shqiptar, posaçërisht po konstruktohen stereotipe negative, por, për dallim nga periudha para dhe periudha pas konfliktit, po shfaqet një zhvendosje e lehtë në drejtim të krijimit të parakushteve dhe tejkalimit gradual të stereotipizimit negativ. Stereotipet të cilat dy komunitetet më të mëdha etnike në vend po i konstruktojnë, janë ato ndaj komunitetit etnik turk, dhe të cilat janë jashtëzakonisht pozitive, si dhe ndaj komunitetit etnik rom, ku ato janë jashtëzakonisht negative.
- Paragjykimet e grupit etnik shqiptar dhe atë maqedonas kanë *veçori paternaliste* fuqishëm të shprehura, si dhe *komponentin konkurrues*. E para ka të bëjë me një tension fuqishëm të theksuar kur bëhet fjalë për veçoritë e vlerave dhe nivelin kulturor të “Tjetrit”, kurse e dyta tregon për marrëdhënie konkurruese midis grupeve etnike, nxitur nga ndjenja e rrezikimit dhe qasja e kufizuar në resurset njerëzore.
- Distanca etnike në vendin tonë akoma është shprehur edhe më tepër, e cila ka të bëjë me përkatësinë konfesionale dhe me veçoritë e përgjithshme kulturologjike. Ajo që inkurajon, është tendenca e shprehur qartë e uljes së distancës etnike, e cila mund të vërehet në marrëdhëniet e ndërsjella si tek komuniteti etnik maqedonas, ashtu edhe tek ai shqiptar. Pavarësisht nga afërsia më e madhe akoma e shprehur, tendenca e vetme e rritjes së distancës etnike qëndron në marrëdhëniet e komunitetit etnik maqedonas ndaj komunitetit etnik serb.
- Në vendin tonë, distanca më e madhe ndërpersonale qëndron në raportet që të dy komunitetet më të mëdha etnike po i ndërtojnë ndaj komunitetit rom. Në marrëdhëniet e ndërsjella të komunitetit etnik maqedon dhe atë shqiptar, distanca më e madhe ndërpersonale për sa u përket çështjeve qëndron në lidhje me institucionet tradicionale, siç është martesja, por ajo është konsiderueshëm më e ulët kur shqyrtohen perceptimet e bashkëveprimit ndëretnik të bazuar mbi ndërtimin e lidhjeve miqësore. Befason fakti se edhe përskaj të segregimit në kuadër të sistemit arsimor, distanca arsimore nuk është edhe aq e shprehur. Lidhur me distancën fetare, është i dukshëm distancimi më i madh i pjesëtarëve të komunitetit islam në raport me konfesionet tjera, nëse bëjmë krahasimin me qëndrimet e pjesëtarëve të konfesionit ortodoks të krishtër në raport me të tjerët.
- Etnocentrizmi dhe identifikimi me përkatësinë fetare janë fuqishëm të shprehur. Edhe pse, ato janë më të shprehur tek komuniteti etnik shqiptar, prapëseprap tendenca për rritjen e rëndësisë e cila i kushtohet kombit si identifikimin primar grupor, po vërehet edhe tek komuniteti etnik maqedonas.
- Ndjenja e ulët e identifikimit me shtetin, e cila është e pranishme edhe tek komuniteti etnik maqedon edhe tek ai shqiptar mund në të ardhmen të kontribuojë për reduktimin e ndjenjës së besnikërisë ndaj saj. Lidhur me këtë lloj të besnikërisë, ekziston një tendencë kundër-proportionale e cila ndjek fuqizimin e ndjenjës kombëtare dhe tendencës për fuqizimin e etnifikimit në kontekstin shoqëror maqedonas.
- Përkatësia fetare tek të anketuarit shqiptarë është barabartësisht e rëndësishme si dhe përkatësia etnike, përderisa tek maqedonasit ajo po lëviz drejt më pak të rëndësishmes.
- Kur bëhet krahasimi, mund të vërehet tendenca e reduktimit të përqindjes së shpeshtimit në të gjitha bazat, me përqindjen më të lartë tek perceptimi për ekzistimin e diskriminimit, pastaj tek ekzistimi i gjuhës së urrejtjes, dhe në fund tek shpeshtimi i krimit nga urrejtja. Kjo gjë është dhe e logjikshme, pasi që diskriminimi si dukuri është shumë më i gjerë, për dallim nga gjuha e urrejtjes, e posaçërisht për dallim nga krimi nga urrejtja, edhe pse që të tre dukuritë shfaqen paralelisht për shkak të ekzistimit të paragjyqimeve negative dhe stereotipeve ndaj grupeve të ndryshme të njerëzve në shoqëri.
- Sipas rezultateve të hulumtimit, perceptimi për ekzistimin e diskriminimit është akoma më i përhapur se perceptimi se diskriminimi po mungon. Bazat e diskriminimit për të cilat pretendohet se janë më të shpeshta, janë diskriminimi në bazë të përkatësisë partiake dhe përkatësisë etnike, vijuar nga orientimi seksual, feja ose bindja, dhe hendikepi. Niveli më i ulët i ekzistimit të diskriminimit vërehet tek baza gjini dhe moshë, i cili është falë nivelit të ulët të kuptuarit të formave të ndryshme të diskriminimit mbi këtyre bazave në shoqëri.

- Gjysma e të anketuarve nuk identifikojnë mjaftueshëm marrjen e masave në luftën kundër diskriminimit. Nga të dhënat e grumbulluara mund të shihet se përsëri, ata që konsiderojnë se diskriminimi është një dukuri e shpeshtë, kanë prirje më tepër për të konsideruar se marrja e masave për luftë kundër diskriminimit është e pamjaftueshme.
- Hulumtimi zbuloi se një e pesta e të anketuarve janë paraqitur si viktime të gjuhës së urrejtjes. Rezultatet e grumbulluara prapëprap nuk reflektojnë gjendjen reale me gjuhën e urrejtjes në vend, duke patur parasysh se popullata akoma nuk është mjaftë e sensibilizuar për ta identifikuar këtë dukuri. Posaçërisht brengos mosidentifikimi i gjuhës mizogjenike, e cila është mjaftueshëm e përfaqësuar në diskursin publik nga të gjitha grupet, si dhe mosidentifikimi i gjuhës homofobike nga të anketuarit e komunitetit etnik shqiptar dhe nga të anketuarit e konfesionit musliman.
- Sipas rezultateteve të hulumtimit, perceptimi për ekzistimin e gjuhës së urrejtjes, në mënyrë identike si tek përgjigjet për shpeshimin e diskriminimit, është akoma më i përhapur se perceptimi se ajo po mungon. 47,4% të të anketuarve konsiderojnë se gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë politike është një dukuri e shpeshtë, ndërsa 42,5% se baza është përkatësia etnike, vijuar nga shpeshimi i gjuhës së urrejtjes në bazë të orientimit seksual (40,4%), fesë ose bindjes (36,8%), hendikepit (26,8%), gjinisë (21,6%) dhe moshës (15,2%). Ajo që mund të vërehet për këtë hulumtim është se ka një numër konsiderueshëm të lartë të përgjigjeve “nuk e di”, i cili graviton midis 11,2% për bazën përkatësi etnike dhe fe ose bindje, e deri në 18,1% për bazën hendikep.
- Gjuha e urrejtjes në bazë të moshës po karakterizohet me një nivel të ulët të shpeshimit, dhe vërehet tek të gjitha grupet e të anketuarve barazisht, pa lëvizje të mëdha në kuptimin e veçorive socio-demografike të tyre.
- Në mënyrë identike si dhe tek perceptimi, për ekzistimin e diskriminimit, se sa shpesh do të perceptohet një formë e caktuar e gjuhës së urrejtjes ose e krimit nga urrejtja, varet edhe nga ajo nëse në rrethin shoqëror të të anketuarve janë përfaqësuar edhe pjesëtarë të grupeve të ndryshme që janë të prirura ndaj gjuhës së këtyllë ose krimit, si dhe nëse të anketuarit definojnë veten si pjesëtarë të grupit pakicë, gjë kjo e cila mund të paraqitet si lëndë e gjuhës së urrejtjes ose krimit nga urrejtja.
- Hulumtimi zbuloi se 17,9% të të anketuarve janë paraqitur si viktime të krimit nga urrejtja. Rezultatet e grumbulluara prapëprap nuk pasqyrojnë plotësisht gjendjen reale me krimin nga urrejtja në shoqëri, nëse kihet parasysh se popullata akoma nuk është sensibilizuar mjaftueshëm në kuptimin e njohjes së kësaj dukurie dhe manifestimet e saja.
- Hulumtimi zbuloi se 42,2% të të anketuarve konsiderojnë se krimi nga urrejtja në bazë të përkatësisë politike paraqet një dukuri të shpeshtë, ndërsa 33,9% konsiderojnë se baza është përkatësia etnike, e vijuar nga shpeshimi i krimit nga urrejtja në bazë të fesë ose bindjes (28,7%), orientimit seksual (28,5%), hendikepit (18,6%), gjinisë (15%) dhe moshës (13,9%). Një e katërta e të gjithë të anketuarve në mesatare janë përgjigjur me “nuk e di” në pyetjen për shpeshimin e krimit nga urrejtja në bazat në fjalë. Posaçërisht brengos njohja e krimit nga urrejtja në bazë të orientimit seksual nga të anketuarit e komunitetit etnik shqiptar dhe të anketuarit e konfesionit musliman.

REKOMANDIMET

- Përforcimi i mundësive për bashkëveprim ndëretnik të të rinjve, sidomos të atyre që rrjedhin nga lagje etnikisht homogjene, nëpërmjet të programeve alternative arsimore, siç janë kampet, kurset, punëtoritë, e ngjashëm.
- Futja në përdorim të mësuarjes fakultative të gjuhëve të komuniteteve që jetojnë në vend, në kuadër të sistemit arsimor. Përqëndrimi duhet të vihet në gjuhët që fliten në kuadër të komunitetit lokal.
- Krijimi i programeve arsimore për bashkëveprim ndëretnik, ku do të përfshiheshin përmbajtje me rëndësi për komunitetet e ndryshme etnike, dhe me të cilën gjë do të pakësohej distanca etnike dhe stereotipet negative, si dhe do të rritej niveli i bashkëjetesës ndretnike brenda shoqërisë.
- Ndërtimi i parakushteve për pakësimin e etnocentrizmit fuqishëm të shprehur, nëpërmjet të mekanizmave të cilët do ta fuqizonjin konceptin civil, si dhe nëpërmjet të fuqizimit të ndjesisë së përkasjes shtetit.
- Fuqizimi i kapaciteteve të universiteteve, nëpërmjet të bashkëpunimit më intensiv me institucionet përkatëse shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjeve lokale, në drejtim të rritjes së bashkëveprimit ndëretnik dhe fuqizimit të inkluzionit shoqëror në bazë të pyetjeve që nuk kanë një dimension fuqishëm të shprehur etnik dhe fetar.
- Një përqëndrim të veçantë duhet vënë mbi mundësinë e pakësimit të distancës etnike më fuqishëm të shprehur në drejtim të komunitetit etnik rom, nëpërmjet të rritjes së mundësisë për inkuadrimitin e anëtarëve të këtij komuniteti në kuadër të institucioneve të arsimit të lartë në vend.
- Sensibilizimi i qytetarëve për format e ndryshme të diskriminimit dhe rritja e nivelit të njohurive dhe informimit. Me këtë, rekomandohet stimulimi i prezantimit përkatës mediatik të diskriminimit dhe pasojat e diskriminimit mbi realizimin e të drejtave dhe lirive bazë të grupeve të ndryshme të qytetarëve.
- Ngritja e vetëdijes publike për format e ndryshme shfaqëse të gjuhës së urrejtjes dhe praktikave e mira në nivelin kombëtar dhe lokal për tejkalimin e saj. Lufta me gjuhën e urrejtjes duhet të bazohet mbi një qasje tre-shtesore: zhvillimi i politikave pozitive; mbrojtja e procedurave administrative dhe civile dhe përcaktimi i sanksioneve penale. Parimet *Camden* për lirinë e shprehjes dhe barazisë paraqesin një udhërrëfyes të dobishëm për politikave dhe masat pozitive, me të cilat garantohet liria e shprehjes dhe barazia në shoqëri.
- Marrja e masave parandaluese kundër krimit nga urrejtja, duke përfshirë këtu dhe edukimin mbi të drejtat e njeriut dhe ngritja e vetëdijes publike për vlerën e diversitetit kulturor dhe të inkluzionit, duke patur në shënjestër të gjitha pjesët e shoqërisë, që të luajnë rolin e vet në luftën kundër jotolerancës së tillë.

SHTOJCA 1 – Metodologjia

Në kuadër të këtij hulumtimi, është përdorur qasja metodologjike kuantitative, me zbatimin e një pyetësi anketues, ku janë përfshirë 519 të anketuar. I tërë ekzemplari përfshiu të rinj (nxënës të shkollave të mesme dhe studentë), ku bazat gjinore, etnike, fetare dhe shoqërore janë përfaqësuar në mënyrë përkatëse dhe të cilat janë të pranishme në shoqëri dhe ato janë përzgjedhur me zgjedhje të rastit. Kështu, janë përdorur pyetje të mbyllura me më tepër kategori të pyetjeve me më shumë përgjigje alternative, shkalla nga 1 deri 5 (duke u nisur me plotësisht pajtohem e deri në nuk pajtohem aspak), me listë të ofruar të stereotipeve, si dhe Shkalla e Bogardusit dhe Shkalla e Likertit për matjen e distancës etnike dhe shkallës së përkasjes grupeve respektivisht të ofruara.

Pyetësorët janë zbatuar në kuadër të universiteteve “Goce Dellçev” – Shtip, “Shën Kirili dhe Metodi” – Shkup, si dhe pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës. Gjithashtu, janë përfshirë disa shkolla të mesme në Shtip, Strumicë, Vinicë, Shkup, Tetovë dhe Gostivar. Për procesimin e të dhënave është përdorur programi statistikor SPSS për procesimin e të dhënave.

Qasja krahasuese përfshin krahasimin me hulumtimet për stereotipet dhe distancën etnike, të zbatuara në vitin 1995 nga prof. d-r Marija Tasheva, dhe në vitin 2003 nga prof. d-r Frosina Tashevskaja Remenski (Tasheva, 1997; Tashevskaja, 2003).

Në gjetjet e këtij hulumtimi, aty ku ishte e mundur, për pyetjet identike janë bërë krahasime me rezultatet e një hulumtimi të ngjashëm të zbatuar në vitin 2009 (Petroska Beshka, Najçevska, 2009) si dhe me hulumtimin identik të zbatuar në vitin 2013 (Popoviç, Mihaellovska, 2013). Referenca e të dhënave të këtyre hulumtimeve për qëllime komparative është bërë duke përmendur vitin (2009) dhe (2013), respektivisht.

SHTOJCA 2 – Pyetësi anketues

(1) 1. Gjinia 1 m 2 f

(2) 2. Moshë 1 nga 16 deri 18 vjeç 2 nga 19 deri 21 vjeç 3 nga 22 deri 24 vjeç

(3) 3. Zona e banimit 1 fshat 2 qytet

(4) 4. Përkatësia etnike

1 Maqedone 2. Shqiptare 3. Turke 4. Rome 5. Serbe

6. Vllehe 7. Tjetër _____

(5) 5. Konfesion

1 Ortodoks 2 Islam 3 Katolik 4 Protestant

5 Ateist 6 Tjetër _____

(6) 6. Arsimiti 1 Nxënës i shkollës së mesme 2 Student 3 Tjetër _____

(7) 7. Shënoni Universitetin / Shkollën e mesme ku studioni/mësoni

_____.

(8) 8. Të ardhurat mesatare në kuadër të familjes

1 deri 8 000 den. 2 nga 8 000 deri 15 000 den. 3 nga 15 000 deri 30 000 den.

4 nga 30 000 deri 60 000 den. 5 mbi 60 000 den.

(9) Përveç gjuhës amë, cilën gjuhë tjetër njihni, nga gjuhët e numëruara më poshtë:

	Gjuha	1 Lexoj dhe shkruaj	2 Lexoj	3 Përdor sa për komunikim	4 Nuk e njoh
(9)	maqedone				
(10)	shqipe				
(11)	turke				
(12)	rome				
(13)	rome				
(14)	tjera				

(15) 10. Si e përcaktoni religjiozitetin Tuaj?

1 Nuk jam religjioz 2 Jam pak religjioz

3 Nuk jam i përcaktuar fetarisht 4 Religjioz 5 Jam shumë religjioz

(16) 11. Cili është (ka qenë) profesioni i njërit nga prindërve Tuaj?

1. Bujk
2. Punonjës në sektorin privat dhe në bujqësi
3. Punonjës në sektorin shoqëror dhe në SH.A.
4. Zejtar privat dhe tregtar
5. Nëpunës
6. Profesor universitar, kuadër i lartë në institucionet shkencoro-hulumtuese dhe në profesionet e lira
7. Kuadër udhëheqës në organizatat e punës dhe në institucionet shtetërore
8. Privatist (pronar i ndërmarrjes më të madhe)
9. I papunësuar
10. Amvis/e

II

Do t'u parashtrojmë disa pyetje për amvisërinë Tuaj dhe për kushtet Tuaja të banimit:

(17) 12. Sa anëtarë numëron amvisëria Juaj? _____

(18) 13. Sa brezëshe është amvisëria Juaj?

1. Një-brezëshe (burrë dhe grua)
2. Dy-brezëshe (prindër dhe fëmijë)
3. Tre-brezëshe (prindër, fëmijë dhe nipërinj/mbesa)
4. Më shumë brezëshe dhe me familjarë tjerë

(19) 14. A duhet gjatë shkollimit, të mësohet dhe njëra nga gjuhët që fliten në vend?

1. Jo
2. Po, detyrueshëm
3. Po, në mënyrë fakultative (zgjedhore)

(20) 15. Nëse në pyetjen më lartë jeni përgjigjur me po, cilën gjuhë do ta kishit preferuar?

- | | | |
|-------------------|-----------------|----------------|
| 1 gjuhën maqedone | 2 gjuhën shqipe | 3 gjuhën turke |
| 4 gjuhën serbe | 5 gjuhën rome | |

(21) 16. Kush sjell vendimet e rëndësishme në amvisërinë Tuaj?

- | | | |
|-----------|--------------------|----------------------------|
| 1 Babai | 2 Nëna | 3 Babai dhe nëna së bashku |
| 4 Fëmijët | 5 Gjithë së bashku | |

III

Pyetjet në vijim kanë të bëjnë me lagjen Tuaj

(22) 17. Në kuptimin e përbërjes etnike, çfarë është lagjeja Juaj?

1 Etnikisht homogjene

2 Etnikisht e përzier

(23) 18. E çfarë është fqinjëria Juaj?

1 Etnikisht homogjene

2 Etnikisht e përzier

(24) 19. Cilës kombësi i takojnë fqinjët Tuaj me të cilët po shoqërizoheni?

1 kombësisë sime

2 kombësisë sime dhe të një tjetrës

3 kombësisë sime

20. A do të donit të shpërnguleshit nga lagjeja Juaj?

(25) 1. Jo, sepse lagjeja ka infrastrukturën e zhvilluar

2. Jo, sepse lagjeja është ekologjikisht e pastër

3. Jo, sepse banoj afër vendit tim të punës

4. Jo, sepse më përgjigjet përbërja shoqërore e popullatës

5. Jo, sepse jam mësuar këtu

6. Jo, sepse shkoj mirë me fqinjët

7. Jo, sepse nuk kam mundësi të shpërngulem

8. Jo, sepse më përgjigjet përbërja etnike e popullatës

9. Jo, sepse më përgjigjet përbërja fetare e popullatës

(26) 1. Po, sepse lagjeja nuk ka infrastrukturën e zhvilluar

2. Po, sepse lagjeja është e ndotur

3. Po, sepse lagjeja është larg vendit tim të punës

4. Po, sepse nuk e kam të zgjidhur si duhet çështjen e banimit

5. Po, sepse nuk shkoj mirë me fqinjët e mi

6. Po, sepse nuk më përgjigjet përbërja shoqërore e popullatës

7. Po, sepse nuk më përgjigjet përbërja etnike e popullatës

8. Po, sepse nuk më përgjigjet përbërja fetare e popullatës

9. Po, _____

21. Cilit komb i takojnë tre nga miqtë Tuaj më të mirë?

(27) 1 _____

(28) 2 _____

(29) 3 _____

(30) □ 22. Në çfarë lagje do të kishit preferuar të banonit?

1. Në një lagje ku banojnë vetëm pjesëtarë të grupit tim etnik
2. Në një lagje etnikisht të përzier
3. Nuk ka rëndësi

(31) □ 23. A konsideroni se është më mirë të lidhet martesë me:

- 1 një grua/burrë nga feja e njëjtë
- 2 një burrë/grua nga një feje tjetër
- 3 një burrë/grua që nuk është fetar/e
- 4 nuk kam qëndrim të përcaktuar

(32) □ 24. A mendoni se është më mirë të lidhet martesë me:

1. një grua/burrë të përkatësisë së njëjtë etnike
2. një grua/burrë të përkatësisë tjetër etnike
3. nuk kam qëndrim të përcaktuar

25. Cilit konfesion fetar i takojnë tre miqtë Tuaj më të mirë?

(33) □1 _____

(34) □2 _____

(35) □3 _____

26. Ky pyetësor ka të bëjë me ekzaminimin e veçorive karakteristike të kombeve individuale. Për secilin komb që po ekzaminon, keni nga një fletë, në të cilën janë shkruar veçoritë e ndryshme pa ndonjë renditje të posaçme. Detyra Juaj është kjo në vijim: 1. Lexoni me vëmendje të gjitha veçoritë (atributet) e numëruara, e pastaj shënoni numrin përpara pesë deri dhjetë veçoribr për të cilat mendoni se janë tipike apo karakteristike për kombin në fjalë. Veçoritë tipike për një kombë janë ato veçori të cilat i kanë shumica e njerëzve (pjesëtarë) të atij kombi. 2. Nëse konsideroni se kombe të caktuara kanë veçori tjera, të cilat nuk janë numëruar në këtë listë, atëherë i shtoni ato në fund të listës.

	MAQ.	SHQ	TUR.	ROM.	SERB
(36)					
(37)					
(38)					
(39)					
(40)					
(41)					
(42)					
(43)					

- | | | |
|-------------------------------|--------------------------------|--------------------|
| 10. të guximshëm | 30. të sigurtë në vetvete | 50. arrogantë |
| 11. krenarë | 31. të shoqërueshëm | 51. të çiltër |
| 12. tinzakë | 32. të trashë (jointeligjentë) | 52. pijanecë |
| 13. punëtorë | 33. të papastër | 53. të gjindshëm |
| 14. të vonuar | 34. luftarakë | 54. mendjemëdhenj |
| 15. zemerbardhë | 35. nuk duan kombe tjera | 55. temperamentë |
| 16. të pakulturuar në sjellje | 36. joegoistë | 56. të kulturuar |
| 17. të vrazhdë | 37. agresivë | 57. praktikë |
| 18. mikpritës | 38. të arsyeshëm | 58. interesxhinj |
| 19. frigavecë | 39. të hapur | 59. mburravecë |
| 20. të qetë (të tërhequr) | 40. tepër të | 60. ziliqarë |
| 21. të harmonishëm | 41. ndjeshëm | 61. mitmarrës |
| 22. grindavecë | 42. liridashës | 62. kontrabandistë |
| 23. gazmorë | 43. të ngutshëm (të vrullshëm) | |
| 24. egoistë | 44. inteligjentë | |
| 25. përparimtarë | 45. dëshirojnë të sundojnë | |
| 26. të zëshëm (të zhurmshëm) | 46. të butë | |
| 27. të prapambetur | 47. paqedashës | |
| 28. të sjellshëm | 48. të mbyllur | |
| 29. përtacë | 49. të pastër | |

VI

27. Në këtë listë janë numëruar disa grupe etnike, sipas renditjes alfabetike. Përgjigjuni në mënyrë që grupet e numëruara etnike do t'i rradhisni nga 1 deri 5. Para emrit të kombësisë që ndjeni si më të afërt, shënoni numrin 5, para emrit të kombësisë të cilën ndjeni si më të afërt menjëherë pas kombësisë së parë, shënoni numrin 4, dhe kështu me radhë deri në numrin 1.

- (46) □ _____ Shqiptarë
 (47) □ _____ Maqedonas
 (48) □ _____ Romë
 (59) □ _____ Serbë
 (50) □ _____ Turq

VII

28. Në vend jetojnë së bashku pjesëtarë të kombësive dhe feve të ndryshme. Ne na intereson se cilat, nga marrëdhëniet e shënuara, Ju do të kishit patur me pjesëtarin e rëndomtë, as më të mirin, e as më të keqin, të kombësisë dhe fesë individuale. Përgjigjuni në secilën pyetje, në mënyrë që do të shënoni X në kolonën nën emrin e secilës kombësi dhe fe, me përfaqësuesin e së cilës do të kishit dashur ta keni marrëdhënien e shënuar, në mënyrë që të mbeten bosh ata me të cilët nuk do të kishit dashur të kishit marrëdhënie të tilla.

	MAQEDONAS	SHQIPTAR	TURK	ROM	SERB
(51) <input type="checkbox"/> Të banojë në të njëjtën komunë si unë					
(52) <input type="checkbox"/> Të banojë në të njëjtën zonë si unë					
(53) <input type="checkbox"/> Fëmijët e tij të vizitojnë shkollën e njëjtë si fëmijët e mi					
(54) <input type="checkbox"/> Të shoqërizohem me të dhe të jetë miku im					
(55) <input type="checkbox"/> Motra ime ose e afërmja ime të martohet me të					
(56) <input type="checkbox"/> Të jetë kryetar i komunës ku unë banoj					
(57) <input type="checkbox"/> Të jetë udhëheqës në organizatën ku unë punoj					
(58) <input type="checkbox"/> Ta përfaqësojë komunën time në Kuvend					

	ORTODOKS	ORTODOKS	KATOLIK	PROTESTANT	TJETËR
(59) <input type="checkbox"/> Të banojë në të njëjtën komunë si unë					
(60) <input type="checkbox"/> Të banojë në të njëjtën zonë si unë					
(61) <input type="checkbox"/> Fëmijët e tij të vizitojnë shkollën e njëjtë si fëmijët e mi					
(62) <input type="checkbox"/> Të shoqërizohem me të dhe të jetë miku im					
(63) <input type="checkbox"/> Motra ime ose e afërmja ime të martohet me të					
(64) <input type="checkbox"/> Të jetë kryetar i komunës ku unë banoj					
(65) <input type="checkbox"/> Të jetë udhëheqës në organizatën ku unë punoj					
(66) <input type="checkbox"/> Ta përfaqësojë komunën time në Kuvend					

VIII

29. Në këtë pyetësor kemi listuar disa mendime dhe pretendime të ndryshme lidhur me ndjesinë e përkatësisë kombëtare ose me ndjesinë e lidhshmërisë kombëtare për kombin vetjak. Lexojeni me vëmendje secilin pretendim dhe përgjigjuni nëse pajtoheni me të ose nuk pajtoheni. Secila përgjigje që shpreh shkallën e pajtimit ose mospajtimit Tuaj personal - është një përgjigje e mirë. Në secilën pyetje do t'i përgjigjeni duke rrethuar njërin nga përgjigjet e propozuara, e cila më së miri shpreh mendimin Tuaj: plotësisht pajtohem, pajtohem, nuk mund të vendos, nuk pajtohem, nuk pajtohem aspak.

Për shembull, nëse pajtoheni plotësisht me një pretendim, nëse ai plotësisht shpreh mendimin Tuaj, atëherë rrethoni përgjigjen plotësisht pajtohem. Nëse ndonjë pretendim shpreh një mendim i cili është plotësisht në kundërshtim me mendimin Tuaj, atëherë rrethoni përgjigjen nuk pajtohem aspak. Nëse me ndonjë pretendim nuk pajtoheni, por jo plotësisht, atëherë rrethoni përgjigjen nuk pajtohem. Nëse me ndonjë pretendim pajtoheni, por jo plotësisht, atëherë rrethoni përgjigjen pajtohem. Në fund, nëse hasni në një pretendim në të cilin shprehet një mendim me të cilin nuk pajtoheni, e as pajtoheni, atëherë rrethoni: nuk mund të vendos.

	Plotësisht pajtohem	Pajtohem	Nuk mund të vendos	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
(67) □1. Secili komb duhet t'i ripërtërijë dhe ushqejë idealet e veta kombëtare.	1	2	3	4	5
(68) □2. Me braktisjen e çdo lidhshmërie kombëtare, e me pranimin e tërë botës si atdheun e vet, do të krijojm kushte të cilat janë të domosdoshme për mirëqenien dhe përparimin tonë.	1	2	3	4	5
(69) □3. Gjithë pjesëtarët e kombit tim do të duhej, çdoherë dhe në çdo pikëpamje, ta çmojnë kombin e vet më tepër se kombet e tjera.	1	2	3	4	5
(70) □4. Unë, në të njejtën masë, ndjehem si pjesëtar i kombit tim dhe i komunitetit mbarënjëzësor.	1	2	3	4	5
(71) □5. Asnjë veçori e rëndësishme e njeriut si individ nuk rrjedh nga përkatësia e tij kombëtare.	1	2	3	4	5
(72) □6. Ndërgjegjja për përkasjen ndonjë kombi të caktuar, brenda njeriut trazon krenari dhe fisnikëron shpirtin e tij.	1	2	3	4	5
(73) □7. Njerëzimi paraqet komunitetin e vetëm të vërtetë, sepse çdo ndarje e kombeve është ose e dëmshme, ose e pakuptimtë.	1	2	3	4	5
(74) □8. Konsideroj se pjesëtarët e kombit tim, të cilët ngritin kombin e vet mbi kombet e tjera, nuk bëjnë asnjë gjë të keqe, sepse në këtë mënyrë dëshmojnë se sa ata e duan popullin e vet.	1	2	3	4	5
(75) □9. Njerëzit dallohen mes vete sepse u takojnë kombeve të ndryshme, por kjo jo domosdo paraqet pengesë në respektimin e ndërsjellë dhe barazinë.	1	2	3	4	5
(76) □10. Nuk do të kisha mund të them se madje edhe një ndjenjë e imja do të kishte mund të quhej përkatësi kombëtare.	1	2	3	4	5

30.

	Plotësisht pajtohem	Pajtohem	Nuk mund të vendos	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
(77) <input type="checkbox"/> 1. Liria e plotë e gjuhës çon drejt shpërbërjes shoqërore.	1	2	3	4	5
(78) <input type="checkbox"/> 2. Gjyqësori patjetër duhet qenë çdoherë në shërbimin e atyre me fuqi politike.	1	2	3	4	5
(79) <input type="checkbox"/> 3. Sistemi njëpartiak më tepër kontribuon për unitetin e popullit.	1	2	3	4	5
(80) <input type="checkbox"/> 4. Progresi shoqëror çdoherë do të bazohet mbi pronësinë private.	1	2	3	4	5
(81) <input type="checkbox"/> 5. Vetëm sistemi shumëpartiak garanton lirinë e shprehjes.	1	2	3	4	5
(82) <input type="checkbox"/> 6. Socializmi i ka mundësuar siguri më të madhe njeriut të rëndomtë.	1	2	3	4	5
(83) <input type="checkbox"/> 7. Shumica e njerëzve ndjeheshin më të lumtur në sistemin e mëhershëm.	1	2	3	4	5
(84) <input type="checkbox"/> 8. Demokracia është e mirë në teori, por në praktikë kontribuon për probleme të shumta.	1	2	3	4	5

31.

	Plotësisht pajtohem	Pajtohem	Nuk mund të vendos	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
(85) <input type="checkbox"/> 1. Çdo komb patjetër duhet patur shtetin e vet. t	1	2	3	4	5
(86) <input type="checkbox"/> 2. Martesat etnikisht të përziera janë të paracaktuara për dështim.	1	2	3	4	5
(87) <input type="checkbox"/> 3. Dikush mund të ndjehet i sigurt në rrethin e vet vetëm kur shumica e atyre që ka pranë i takojnë kombësisë së njëjtë.	1	2	3	4	5
(88) <input type="checkbox"/> 4. Mund të arrihet bashkëpunimi midis kombësive, por jo edhe besimi i plotë.	1	2	3	4	5
(89) <input type="checkbox"/> 5. Secili duhet të ndiej se fati i kombit të tij është fati i tij personal.	1	2	3	4	5
(90) <input type="checkbox"/> 6. Unë ndiej shkallën e njëjtë të përkatësisë ndaj kombësisë sime dhe ndaj njerëzimit.	1	2	3	4	5
(91) <input type="checkbox"/> 7. Ndjesia për përkatësinë kombëtare është një nga ndjesitë më të bukura.	1	2	3	4	5
(92) <input type="checkbox"/> 8. Është e pandjeshme të thuhet se gjithë kombësitë janë të barabarta kur është e dukshme se disa janë më tepër të vlefshme.	1	2	3	4	5
(93) <input type="checkbox"/> 9. Ata që i takojnë kombit tim do të duhej çdoherë më tepër ta vlerësonjin kombin e vet.	1	2	3	4	5

32.

	Plotësisht pajtohem	Pajtohem	Nuk mund të vendos	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
(94) □1. Gjëja më e rëndësishme është se fëmijët duhet të mësojnë për respektin ndaj prindërve.	1	2	3	4	5
(95) □2. Prindërit duhet ta kenë fjalën kryesore gjatë përzgjedhjes së bashkëshortit të fëmijëve.	1	2	3	4	5
(96) □3. Pa udhëheqës, çdo popull është njeri pa kokë.	1	2	3	4	5
(97) □4. Ekzistojnë dy lloje elementare të njerëzve në botë, të dobët dhe të fuqishëm.	1	2	3	4	5
(98) □5. Secili duhet çdoherë t'i dëgjojë eprorët, pavarësisht nëse kanë të drejtë.	1	2	3	4	5
(99) □6. Sot më me rëndësi se ligjet dhe programet, janë udhëheqësit e pafrikshëm dhe të palodshëm.	1	2	3	4	5
(100) □7. Dikush humb respektin ndaj njerëzve me të cilët po bëhet i afërt.	1	2	3	4	5
(101) 8. Njerëzit nuk dinë se sa shumë jetat e tyre po kontrollohen nga ata në pushtet.	1	2	3	4	5

33. Në këtë pyetje janë renditur njëra ndër tjetrën grupet të cilave u takoni. Përgjigjuni me rrethimin e njëres nga mundësitë (shumë, mesatarisht, pak, aspak) se sa përkasja këtyre grupeve ka rëndësi për Ju.

	Shumë	Mesatarisht	Pak	Aspak
(102) □ Qyteti – fshati	1	2	3	4
(103) □ Rajoni	1	2	3	4
(104) □ Përkatësia etnike	1	2	3	4
(105) □ Konfesionit fetar	1	2	3	4
(106) □ Profesionit	1	2	3	4
(107) □ Shteti	1	2	3	4
(108) □ Ballkani	1	2	3	4
(109) □ Evropa	1	2	3	4
(110) □ Bota, njerëzimi	1	2	3	4

IX

34. A konsideroni se ekziston mospërputhja midis traditës dhe mënyrës bashkëkohore të jetesës?

(111) 1 Po 2 Jo 3 Pjesërisht

35. A po identifikoheni me kulturën e kombësisë Suaj?

(112) 1 Po 2 Jo 3 Pjesërisht

36. A konsideroni se kultura Juaj është nën presionin e një kulture tjetër?

	Jo	Po	Pjesërisht
(113) 1. Kultura maqedone			
(114) <input type="checkbox"/> 2. Kultura shqipe			
(115) <input type="checkbox"/> 3. Kultura turke			
(116) <input type="checkbox"/> 4. Kultura rome			
(117) <input type="checkbox"/> 5. Kultura serbe			
(118) <input type="checkbox"/> 6. Kultura bullgare			
(119) <input type="checkbox"/> 7. Kultura greke			
(120) <input type="checkbox"/> 8. Kultura perëndimore-evropiane			
(121) <input type="checkbox"/> 9. Kultura amerikane			
(123) <input type="checkbox"/> 11. Kultura islame			
(123) <input type="checkbox"/> 11. Kultura islame			
(124) <input type="checkbox"/> 12. Kultura katolike			
(125) <input type="checkbox"/> 13. Kulturat protestante			

37. Cila kulturë, sipas vlerësimit Tuaj, është më agresive në raport me të tjerat, që janë të pranishme në mjedisin tonë?

(126) 1. Maqedone 2. Shqipe 3. Turke

4. Rome 5. Serbe

38. A jeni dhe sa jeni të përfshirë në punën e ndonjë partie politike?

(127) 1. Anëtar aktiv 2. Simpatizues 3. Nuk jam anëtar 4. Nuk më intereson

Pyetjet në vijim kanë të bëjnë me Diskriminimin, Gjuhën e Urrejtjes dhe Krimin nga Urrejtja.

39. A do të kishit mund të na tregonit se çka mendoni, sa është e shpeshtë secila nga format e numëruara të Diskriminimit në vend?

Diskriminimi në bazë të...

1.Nuk ekziston 2.Shumë i rrallë 3.Mjaftë i rrallë 4.Mjaftë i shpeshtë 5.Shumë i shpeshtë 6.Nuk e di

(128)	Përkatësia etnike	
(129)	Gjinia	
(130)	Orientimi seksual (p.sh. homoseksualiteti)	
(131)	Mosha	
(132)	Feja ose bindja	
(133)	Hendikepi (hendikepi mendor dhe trupor)	
(134)	Përkatësia politike	

(135) 40. Marrë në përgjithësi, a do të kishit mund të thonit se në vend po bëhen përpjekje për luftë kundër të gjitha formave të Diskriminimit?

1 Plotësisht po bëhen 2 Mjaftë po bëhen 3 Pamjaftueshëm po bëhen

4 Nuk po bëhen aspak 5 Nuk e di

(136) 41. A keni qenë ndonjëherë lëndë e gjuhës së urrejtjes?

1 Po 2 Jo 3 Nuk e di

42. A do të kishit mund të na thonit se çfarë mendoni, cila është forma e shpeshtë e secilës nga formave të numëruara të Gjuhës së Urrejtjes në vend?

Gjuha e urrejtjes në bazë të...

1.Nuk ekziston 2.Shumë e rrallë 3.Mjaftë e rrallë 4.Mjaftë e shpeshtë 5.Shumë e shpeshtë 6.Nuk e di

(1) (2) (3) (4) (5) (6)

(137)	Përkatësia etnike	
(138)	Gjinia	
(130)	Orientimi seksual (p.sh. homoseksualiteti)	
(140)	Mosha	
(141)	Feja ose bindja	
(142)	Hendikepi (hendikepi mendor dhe trupor)	
(143)	Përkatësia politike	

(144) 43. A keni qenë lëndë ose keni njohuri për ndonjë rast të krimit nga urrejtja?

1. Po 2. Jo 3. Nuk e di

44. A do të kishit mund të më tregoni se çfarë mendoni, sa e shpeshtë është secila nga format e numëruara të Krimit nga Urrejtja në vend?

Krimi nga urrejtja në bazë të...

1.Nuk ekziston 2.Shumë i rrallë 3.Mjaftë i rrallë 4.Mjaftë i shpeshtë 5.Shumë i shpeshtë 6.Nuk e di

(1) (2) (3) (4) (5) (6)

(145)	Përkatësia etnike	
(146)	Gjinia	
(147)	Orientimi seksual (p.sh. homoseksualiteti)	
(148)	Mosha	
(149)	Feja ose bindja	
(150)	Hendikepi (hendikepi mendor dhe trupor)	
(151)	Përkatësia politike	

SHTOJCA 3 – Ekzemplari

Ekzemplari përfshiu 519 të anketuar. Korniza e popullatës së ekzemplarit ishin të rinj, gjegjësisht, nxënës të shkollave të mesme dhe studentë, popullatë mbi moshën 16 vjeçare, e jo më shumë se 24 vjeçare, ndërsa kriteret e përfaqësimit ishin: gjinia, mosha, përkatësia etnike, zona e banimit, feja dhe rajonet.

Gjinia	%
Mashkull	41%
Femër	59%

Mosha	%
16-18 vjeç	46,8%
19-21 vjeç	49,1%
22-24 vjeç	3,3%

Përkatësia etnike	%
Maqedon/e	65,9%
Shqiptar/e	30,1%
Turk/e	1,3%
Rom/e	1,2%
Vlleh/e	1 %
Tjetër	0,6%

Zona e banimit	%
Rurale (fshat)	38,7%
Urbane (qytet)	59%
Nuk ka të dhëna	2,3%

Konfesionit fetar	%
Ortodoks	62,2%
Islam	33,1%
Katolik	0,4%
Protestant	0,2%
Ateist	2,5%
Tjetër	1%
Nuk ka të dhëna	0,6%

Universiteti/Shkolla e Mesme	%
Universiteti “Goce Dellçev” – Shtip	22,5%
Universiteti “Sh. Kirili dhe Metodi” – Shkup	12,3%
Universiteti Shtetëror i Tetovës	24,1%
Shkollat e mesme në pjesën lindore të vendit (Shtip, Vinicë dhe Strumicë)	13,7%
Shkollat e mesme në Shkup	16%
Shkollat e mesme në pjesën Perëndimore të vendit (Tetovë, Gostivar)	10,8%
Nuk ka të dhëna	0,6%

BIBLIOGRAFIA

Beshka-Petroska V., Najçeska M. (2009). Barometri i Mundësive të Barabarta. Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN). Adresa [e internetit]: <<http://www.mcms.mk/images/docs/2009/barometar-za-ednakvi-moznosti-mcms-2009.pdf>> [Vizituar më datë: 30 korrik, viti 2016].

Mihajlova E., Bačovska J., Sheqerxhiev T. (2013). Liria e shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes. Shkup: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Misioni i OSBE-së në Shkup. Adresa [e internetit]: <<http://www.osce.org/mk/skopje/116610?download=true>> [Vizituar më datë: 30 korrik, viti 2016].

OSBE/ODIHR. (2014). Kuptimi i krimit nga urrejtja, edicioni i rishikuar. Varshavë: OSBE/ODIHR dhe Misioni i OSBE-së në Shkup.

Popoviç M., Mihaillovska J. (2013). Barometri i Mundësive të Barabarta – 2013. Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN). Adresa [e internetit]: <http://www.mcms.mk/mk/za-nasata-rabota/istrmuzuvana-i-publikacii/istrmuzuvana/1542_barometar-za-ednakvi-mozhnosti.html> [Vizituar më datë: 30 korrik, viti 2016].

Remenski F. (2004). „Shqiptarët dhe Maqedonasit: Bashkëveprimi etnik në Republikën e Maqedonisë, para dhe pas konfliktit të vitit 2001“. Shkup: Instituti i Sociologjisë, Fakulteti i Filozofisë - Shkup, Universiteti “Sh. Kirili dhe Metodi” - Shkup.

Stojanovski V., Bogoevski P., Barllakovska S. (2016). „Raporti Vjetor mbi Krimin e Urrejtjes në vitin 2015. Shkup: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë dhe Misioni i OSBE-së në Shkup“. Adresa [e internetit]: <http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/1617/ZLORSTORSTVA_OD_OMRAZA_2015_MK.pdf> [Vizituar më datë: 1 gusht, viti 2016].

Tasheva M. (1997). „Grupet etnike në Republikën e Maqedonisë (gjendjet bashkëkohore)“. Shkup: Fakulteti i Filozofisë - Shkup.

